



**Funksionet
e ajeteve
me ilustrime
dinamike**

AJMAN ES-SEJJID ALI ES-SAJJAD

Funksionet e ajeteve me ilustrime dinamike në Kur'anin Fisnik

(funksionet religjioze, psikologjike, edukative, sociale)

Ajman es-Sejjid Ali es-Sajjad

**Doktor i letërsisë dhe retorikës kur'anore
Universiteti Taibah – Medina e Ndritshme**

**Perktheu nga arabishtja në anglishte:
Dr.Hfz.Hajredin Hoxha**

Shqipëroi: Edin Q. Lohja

2009

ح) خير الدين بافتي خوجة ، 1430هـ

عنه نزل لقة بلك لقق غنخك هري ب آتمء؟ بلحمسذ

الصيد ، أيمن السيد

وظائف الآيات القرآنية ذات التصوير الحركي / أيمن السيد الصيد ؛

خيرالدين بافتي خوجة - المدينة المنورة ، 1430هـ

65 ص ؛ 24×17 سم

ردمك : 978-603-00-2396-7

1- القرآن - مباحث عامة 2- علوم القرآن أ- خوجه ، خيرالدين

بافتي (مترجم) ب- العنوان

ديوي 229 1430/2589

رقم الإيداع : 1430/2589

ردمك : 978-603-00-2396-7

الطبعة الأولى : رجب 1430هـ

حقوق الطبع محفوظة للمؤلف



مطابع الرشيد ☎ 920000786

وظائف الآيات القرآنية ذات التصوير الحركي

(الدينية و النفسية و التربوية و الاجتماعية)

دراسة نصية تحليلية

تأليف

الدكتور أيمن السيد الصياد

دكتوراه في البلاغة القرآنية

جامعة طيبة - المدينة المنورة

المملكة العربية السعودية

ترجمه من العربية إلى الإنكليزية

الدكتور خيرالدين خوجة (الكوسوفي)

دكتوراه في التفسير والدراسات القرآنية

جامعة طيبة - المدينة المنورة

المملكة العربية السعودية

PËRMBAJTJA

Falënderime	Shënim i përkthyesit në anglisht	3
Hyrje		5
Abstrakt		6
Kreu I	Funksioni fetar	7
Kreu II	Funksioni psikologjik	29
Kreu III	Funksioni socio-edukativ	44
Përfundim		57
Referenca		60

Në Emër të Zotit, Gjithmëshiruesit, të Plotmëshirshmit

Falënderime

Të gjitha lavdet i përkasin Zotit të Lartësuar, Gjithmëshiruesit, që është Furnizuesi dhe Mbajtësi i gjithësisë. Paqja dhe bekimet e Tija qofshin mbi të dashurin tonë, të dërguarin e fundit, Muhammedin, mbi Shoqëruesit e tij, ndjekësit e tij dhe të gjithë ata që kanë ecur dhe ecin gjurmëve të tij deri në Ditën e Gjykimit.

Jam shumë i lumtur t'u paraqes lexuesve të çmuar përkthimin e këtij studimi të rëndësishëm kur'anor nga kolegu im i nderuar Dr. Ajman es-Sajjad nga Egjipti, që merret me funksionet dhe mësimet e nxjerra nga ilustrimet dhe figurat dinamike në Kur'anin Fisnik. Ky punim është ndër të paktit në kohën e sotme që trajton çështje fetare, shoqërore, edukative dhe psikologjike në të njëjtin vëllim. Duke analizuar stile të ndryshme të elokuencës kur'anore, veçanërisht figuracionin dhe ilustrimet dinamike të shprehura në vargje të shumta të Kur'anit, mund të merren me dhjetëra mësimet e parime të fushave të larmishme.

Gjatë përkthimit është konsultuar versioni i Pickthall, dhe Yusuf Ali.

U jam mirënjohës të gjithë atyre që më kanë ndihmuar në mënyra të ndryshme për ta përfunduar këtë punim. Do të dëshiroja t'i përcillja falënderimet e mia të ndjera, lutjet dhe vlerësimin tim kolegëve të mi të respektuar dhe miqve të nderuar për mbështetjen e tyre të paçmueshme që më kanë ofruar. Kam përfituar nga komentet e tyre kritike, recenzimet dhe sugjerimet, ndonëse pa u pajtuar gjithmonë me pikëpamjet dhe përkthimet e tyre. E kam për detyrë të përmend emrat e tyre.

I jam veçanërisht borxhli Dr. Nasir Salih el-Kadi, ish-in Dekan i Community College dhe Profesor i Gjuhësisë dhe letërsisë Angleze në Universitetin Taibah, Dr. Shaukat el-Ensari, Profesor i Gjuhësisë dhe Letërsisë Angleze në Universitetin Taibah, i cili vjen nga India; Mr. Nafid Akhtar dhe Mr. Talib Alexander nga Mbretëria e Bashkuar, të cilët japin anglisht në Universitetin Taibah.

Allahu derdhtë mëshirën e Tij mbi ta dhei shpërbleftë për përpjekjet shkencore në kontrollimin dhe rishikimin e këtij punimi.

Më në fund, falënderime të veçanta Allahut të Madhëruar, i Cili ishte tejet i mirësishëm ndaj meje gjersa e përfundova këtë detyrë.

Prof. Dr. Hajredin Hoxha
Universiteti Taibah, Medina e Ndrishme, 06.06.2009

Hyrje

Kur'ani Fisnik përmba shumë fjalë dhe figura dinamike. Vargjet e figurave dinamike në Kur'an përmbajnë funksione në formën e konfigurimeve të shumta e të larmishme. Këto funksione i vërejmë në spektrin e gjerë, bashkë me funksionet e llojeve të tjera. Disa prej tyre na ofrojnë epërsi të ndryshme në mënyrë një funksion. Për shembull, një fjalë dinamike mund t'i referohet një epërsie edukative dhe njëkohësisht figuracioni i tij dinamik ofron epërsi psikologjike dhe informative. Figura e një kopraci dhe dorëlëshuari tregohet në mënyrë dinamike me anë të mbajtjes dhe zgjatjes. Në mënyrë të ngjashme, kjo mund të shihet edhe te shumica e fjalëve dinamike.

Në faqet vijuese të këtij punimi, do të përpiqemi të studiojmë funksionet dhe epërsitë kryesore, që figura dinamike e vargjeve në Kur'an i paraqet dhe i bën të qarta, dobiprurëse dhe efikase. Kësisoj, punimi ndahet në tri pjesë, çdonjëra nga të cilat merret me funksionin e përgjithshëm përkatës dhe epërsitë e tija të ndryshme. Mbështetur në këtë metodologji, mund të specifikojmë funksionet më të rëndësishme të vargjeve, që ka formuar figuracioni dinamik për t'i shërbuar tekstit kur'anor dhe synimeve të tija të epërme.

Më konkretisht, funksionet e figuracionit dinamik do të diskutohen në tre pjesët e mëposhtme, sipas kësaj renditjeje:

- 1- Funksioni fetar**
- 2- Funksioni socio-edukativ**
- 3- Funksioni psikologjik**

Dijetarë të jerë mund të zbulojnë funksione të tjera në analizën e tyre të figurave dinamike. Kurse ky studi do të përqendrohet te funksionet më të rëndësishme narrative në Kur'anin Fisnik. Kjo është pikëpamja e kërkuesit në të zgjedhurit e funksioneve më të përgjithshme, që paraqesin objektiva të qarta, efekte të mëdha e domethënie të larmishme.

Abstrakt

Në këtë studim, kërkuesi përpiket të hedhë dritë mbi figuracionin dinamik në Kur'anin Famëlartë, të cilin e konsideron aspekt të ri të gojtarisë së mrekullishme të tij. Kjo përpjekje bëhet për t'i shërbyer Kur'anit Fisnik dhe synuar shpërblimin e Zotit. Studimi fokusohet tek vargjet kur'anore me figuracion dinamik, duke u përqendruar në zbatimet e drejtpërdrejta të tyre nëpërmjet shprehjeve gojore dhe pranisë së tyre në këto figura dinamike.

Studimi diskuton funksionet më të rëndësishme të figurave dinamike që pasqyrohen në ajetet kur'anore. Këto funksione janë fetare, psikologjike, socio-edukative, informuese, artistike, shkencore, etj. ato përfshijnë edhe mrekullitë shkencore në Kur'anin Fisnik.

Termi 'dinamik' përkufizohet si lëvizja faktuale e shprehur nga trupi ose pjesët e tij. Ai përfshin lëvizjen e dorës ose të asaj që e simboizon atë, lëvizjen e syrit ose asaj që e simbolizon atë, kthimin e kokës në një drejtim të caktuar, komentimin e një skene, dhe diskutimin ose pjesëmarrjen në një opinion nëpërmjet një shenje. Kështu, lëvizja përkufizohet si shenja shprehëse e materializuar nga një shenjë. Kështu, lëvizja përkufizohet si shprehja e materializuar e shenja nëpërmjet përdorimit të pjesëve trupore.

Në këtë studim, termat 'dinamik' dhe 'figurë' përdoren së bashku. Me fjalë të tjera, ajetet e Kur'anit Fisnik do të analizohen sipas disponueshmërisë së portretizimit dhe lëvizjes në të njëjtën kohë, tek një ajet ose ngjarje e caktuar. Kësisoj, portretizimi dhe lëvizja trajtohen si dy krahe të një zogu dhe nuk do të ndahen nga njëri tjetri përveçse për arsye shpjegimi ose analize.

KREU I

Funksioni fetar

Shumë ajete kur'anore përcjellin një figurë dinamike me funksione të ndryshme fetare dhe tjetërsoj. Mes këtyre funksioneve, mund të përmendim të mëposhtmit:

1- *Bindje ndaj Zotit,*

2- *Kundërshtimi i dëshirave dhe cytjeve të Shejtanit,*

3- *Të kapurit fort pas udhërrëfimit islam dhe mosshmangia nga mësimet e tija hyjnore;* përndryshe, njeriu do të kërcënohej dhe do humbiste, i rrethuar nga frika dhe çregullimi. Ai ndjen dhe jeton në një gjendje shkatërrimi dhe fatkeqësie. Atë e rrethon errësira; mbi të janë re, bubullima e vetëtima. Kjo është gjendja e njeriut që ka devijuar dhe është shmangur nga rruga e drejtë.¹ Zoti thotë në Kur'an:

Rasti i tyre shëmbëllen me rastin e atyre që ndezin një zjarr dhe, kur ai ua ndriçon ç'kanë rreth vetes, Allahu ua merr dritën, i lë në errësirë dhe ata nuk shohin asgjë!

Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, prandaj nuk kthehen në rrugë të drejtë.

Ose shëmbëllen me ata që, gjatë shtrëngatës nga qielli, shoqëruar me errësirë, bubullimë dhe shkrepimë, i mbyllin veshët me gishtat e tyre, për të mos dëgjuar ushtimën nga frika e vdekjes. Kështu, Allahu i ka nën kontroll mohuesit.

Shkreptima, pothuaj, ua merr shikimin. Sa herë që ajo ua ndriçon rrugën, ata ecin dhe, kur i kaplon errësira, ndalen. Sikur të donte Allahu, do

1 Shih: el-Fakhr el-Razi, *el-Tafsir el-Kabir ve Mafatih el-Ghajib*, Vvll. 2, ff. 79-89; el-Kurtubi, *el-Xhami' li Ahkam el-Kur'an*, Vvll. 1, ff. 228-242; el-Nisabūri, *Ghara'ib el-Kur'an wa Ragha'ib el-Furkân*, Vvll. 1, ff. 180-187; el-Shevkani, *Fat'h el-Kadir*, Vvll. 1, ff. 45-48.

t'ua merrte dëgjimin dhe shikimin. Pa dyshim, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë. **(el-Bekare: 17-20)**

Kur'ani Fisnik përmend dhe përshkruan gjendjen e adhuruesve që synojnë mëshirën dhe faljen e Zotit² në pozicione dhe stile të ndryshme, sikurse në këmbë, ndenjor, në gjumë, të shtrirë në krah, dhe gjatë meditimit në çdo kohë dhe formë. Në sajë të këtyre pozicioneve dhe stileve të adhurimit, du'atë, përgjërimet, dhe pendesa bëhen të shumta. E gjithë kjo bëhet për të arritur kënaqësinë e të Madhërishmit, me dëshirën për t'u shuar tek Ai dhe për t'u falur prej Tij, duke soditur fuqinë e Tij të epërme, dhe pohuar hyjnitetin e Tij. Fuqiploti ka parajsën dhe ferrin në dorën e Tij. Njerëzit përpiqen për të parën dhe kërkojnë strehim ndaj të dytit. I Gjithfuqishmi zotëron gjithçka, siç ilustron vargu i mëposhtëm:

"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit." **(Al-i Imran: 190-191)**

Pas kësaj, ata që e dinë të vërtetën dhe përpiqen për të nuk janë të barabartë me ata që e njohin dhe kthehen mënjandë prej saj. Ata nuk meditojnë për krijimin e qiejve dhe të tokës, e as nuk e adhurojnë Atë, nuk i druhen dënimit të Tij, dhe nuk e kërkonë mëshirën e Tij. A jana të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?

Figurat dinamike në disa vargje të Kur'anit Fisnik që merren me erërat³ tregojnë dobi shumë të rëndësishme fetare. Dobi të tilla meritojnë të menduarit dhe të soditurit rreth krijimit të Zotit. Era është krijim i Zotit dhe

2 Shih: el-Tabari; *Xhami' el-Bajān 'an Ta'wil Ajat el-Kur'ān*, Vvll. 4, ff. 209-210; el-Nisaburi, Vvll. 4, ff. 147-159. For a list of detailed similarities refer to ajeti 9 of Sure *el-Zumer*.

3 Shih: el-Razi, vvll. 7, p. 43; Sejid Kutb, *Fi Zilal el-Kur'an*, vvll. 3, ff. 1298-1300; Sure *el-Dharijat*, vargjet 1-3, 41-42, Sure *Al Hakkah*, vargjet 6-7.

ndodhet nën urdhrin e Tij të plotë. Ajo sjell jetë dhe rritje; ajo pjalmon bimët dhe pemët, rrit drithërat dhe frutet, shtyn retë, zbret shiun, dhe përhap shpresë dhe zhvillim kudo. Këto figura të mrekullueshme mund të vërehen në këto vargje të Kur'anit Famëlartë:

“Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi, Ai i çon ato tek ndonjë vend i vdekur, ku lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash; po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Këta janë shembuj që t'ua vini veshin.” (el-A'raf: 57)

Era mund të sjellë edhe ndëshkim të rreptë, kufizim, dhe fatkeqësi kur u dërgoet mohuesve të begative të Zotit dhe të lajmëtarëve të Tij. Ajo i shkatërron ata, ua privon jetët dhe ua çrënjos pemët. Si rrjedhojë, retë u bëhen ndëshkim mbi koka, ndërsa erërat helm në hundë, duke u fryrë atyre dhunshëm, si të ishin rrënjë palmash të shkulura vendi. Zoti Fuqiptotë thotë në Kur'anin Famëlartë:

“Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme të pandërprerë, e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash.” (el-Kamer: 19-20)

Mbi bazën e figurave të treguara të erës, bëhet shumë e qartë për ne sa e mrekullueshme është urtia e Zotit të lartësuar në ndryshimin e erës. Nganjëherë erërat janë dobiprurëse, nganjëherë jo. Erërat dhe sihqriqet për adhuruesit e durimshëm janë torturë e dhimbshme për gënjeshtarët dhe njerëzit e shmangur nga udha.

Në një rast tjetër, figuracini dinamik i Kur'anit Fisnik tek ngjarja e Ademit dhe Havasë⁴ na e ka shpalosur gjendjen e tyre të turpits dhe pendesës pasi iu mosbindën urdhëresave të Zotit të tyre. Zoti i tyre ua kishte ndaluar afrimin ndaj pemës së mallkuar. Është e vërtetë që egoja e njeriut priret për keq. Ademi dhe Havaja hëngrën nga pema e ndaluar, ndoqën Shejtanin, dhe i besuan premtimit të tij për përjetësi. Kjo ua bëri velin e tyre të dukshëm

4 Shih el-Razi, vull. 14, ff. 48-52, si dhe ajeti *Tāhā*: 121.

dhe ata i zuri turpi për njëri tjetrin, ngase pjesët intime u ishin bërë të shfaqura. Ata u përpoqën t'i mbulonin shpejt me gjethe pemësh, por ishte tepër vonë. Çështja nuk është te mbulimi i pjesëve intime, por mosbindja ndaj urtisë hyjnore të urdhrit të mosafritit ndaj pemës së mallkuar, duke kuptuar më pas se pjesët intime ishin zbuluar, gjë që përbën një paranjohje të ndëshkimit të rëndë që i priste. Zoti Fuqplotë e ilustron këtë imazh të mrekullueshëm me vargjet e mëposhtme:

“Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethe e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri: “A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?”

(el-A'raf:22)

Disa vargje të tjera kur'anore merren me udhëzim edukativ,⁵ që është pjesë e fesë sonë, si dhe me parimet e përgjithshme fetare për individin dhe shoqërinë, duke ia kujtuar njeriut se është krijuar nga balta. Njeriu është i dobët, shërbëtor i ulët, dhe nuk mund ta sfidojë këë botë. Ndaj, duhet të jetë i përunjët, dhe duhet ta dijë se përlësia është shenjë e madhe e të drejtësishmëve. Zoti i Madhërishtëm thotë në Kur'anin Fisnik:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”;”,
(el-Furkan:63)

Kështu, arroganca vjen nga mosbesimi dhe injoranca. Robi i thërret Zotit duke iu frikësuar dhe dëshiruar dashurinë dhe nderën e Tij. Atëherë, si mundet ai të bëhet arrogant dhe ta harrojë dobësinë e tij dhe prejardhjen e krijimit të vet? Më i Mëshirshmi thotë:

“Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve.” **(el-Isra: 37)**

5 Shih: el-Basti, *Ravdat el-U'kalā wa Nuz'hatu el-Fudalā'*, ff. 59-62; Ibn Tejmije, *Mekārim el-Akhlak*, ff. 225-230; Hasan Ajjub; *el-Suluk el-Ixhtimai' fi el-Islām*, ff. 61-69; Ahmed Ibrahim, *el-Fadā'il el-Khulukijah fi el-Islām*, ff. 250-257.

Kështu, Madhështia i përket vetëm Atij, Krijuesit, Sunduesit Absolut, të Gjithfuqishmit, Zotit të Nderit dhe Fuqisë. Ai është i pastërt nga çfarë i mveshin!

Në disa ajete të tjera, ka mesazhe të qarta se njeriu duhet të ketë besim të thellë e të fortë tek vendimi dhe përcaktimi i Zotit. Është gjithashtu e vërtetë se pasuria, familja dhe fëmijët e njeriut janë të përkohshme dhe të shuajshme. Asgjë nuk do të mbesë përveç veprave të tija të mira e të drejta. Kështu që ai duhet ta rrisë kryerjen e punëve të mira, t'i jetë mirënjohës Zotit si në lumturi ashtu edhe në mjerim, duke qenë i bindur tek Ai. Bota i mashtron njerëzit dhe nuk ka besë. Ajo sjell pikëllim dhe pishmanllëk. Kushdo që kapet pas saj do të turpërohet, kurse ai që e braktis do të nderohet prej Zotit të tij. I pasuri duhet ta dijë se është përfaqësues i Zotit në pasurinë e tij. Ai do të merret në pyetje rreth saj: nga e ka fituar, dhe ku e ka shpenzuar. Njeriu duhet të jetë i kujdesshëm për pasurinë e vet sepse ajo mund t'i sjellë shkatërrim.⁶ Kjo figurë mund të vërehet në këto ajete vijuese:

“Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet) – e që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët - dhe thërriste: “Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!”

(el-Kehf: 42)

Në vargje të tjera kur'anore, figura dinamike e Kur'anit Fisnik paraqet vështirësinë e kalimit mbi ferr dhe hyrjen në parajsë. Nuk është detyrë e lehtë të shpëtosh nga zjarri i xhehenemit dhe të marrësh faljen e më të Mëshirshmit Zot. Kushdo që është përpjekur fort dhe i është kundërvënë shejtanit të vet kthehet me shpirtin e tij të çliruar nga dria e besimit, duke recituar Kur'anin Fisnik, duke u lutur për falje, dhe duke shpresuar hyrjen në Parajsë. Kjo ka çuar në përpjekje të fortë, braktisje të kënaqësisë së kësaj jete, duke vështuar përpara tek Ahireti, dhe ofruar bindje. Kësisoj, shpërblimi i tij, futja në parajsë është në përputhje me veprimet e tija. Tek e

⁶ El-Rāzi, Vvll. 21, ff. 124-129; Abd el-Mexhid el-Bajānūni, *Darbu el-Amthāli fi el-Kur'an*, Dar el-Kalam, Damask, 1991, f. 65; Ibn Tejmijeh, ff. 231-239; el-Basti, ff.153-156.

fundit, a është shpëtimi i vetvetes nga skëterra detyrë e thjeshtë? Për Zotin, jo. Ajo kërkon zhvendosje, vështirësi, vuajtje, përpjekje, rëndesë, dhe palëkundshmëri. Shpërblimi për kryerjen e veprave të mira është njëlloj.⁷ Le ta shohim këtë figurë të mrekullueshme dinamike në Kur'anin Fisnik:

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.”

(Al-i ‘Imran:185)

Disa vargje të Kur’anit Fisnik përshkruajnë sjelljen e ulët dhe absurde të jobesimtarëve që kthehen mënjane nga të dërguarit e Zotit.⁸ Kjo konfigurohet nga stili magjik kur’anor i retorikës dhe elokuencës në këto pika:

1- Pretendimet e tyre të rreme se ata ishin në rrugën e drejtë, duke tallur të dërguarit.

2- Pakënaqësia e tyre me përgjigjet e të dërguarve për shkak të deluzioneve dhe mashtrimeve të tyre.

3- Rrëfimi i tyre se Zoti Fuqiptotë nuk i njeh misteret dhe bisedat e tyre të fshehta para fjalës dhe pyetjes së tyre.

4- Duke vendosur përpara jobesimtarëve figurën e rrugës së drejtë dhe figurës së dënimit, duke i motivuar që të besonin dhe ta braktisnin devijimin. Ata që i binden të Dërguarit të Zotit janë në të drejtën, kënaqësinë, dhe Xhenetit, ndërsa ata që i mosbinden janë në shmangie, humbje, torturë dhe Skëterrë.

5- Shumica e figurave dinamike në Kur’anin Fisnik sjellin në pah lëvizjet dhe sjelljet e tyre të çuditshme dhe të pakontrolluara ndaj të dërguarve të Zotit. Kur’ani Fisnik i përqesh ata duke bërë që të ndjejnë ata me të cilën kanë përqeshur të dërguarit. Disa prej tyre mbulonin kokat për të mos dëgjuar asnjë fjalë, të tjerët kafshonin duart për shkak të pikëllimit dhe pendesës së tyre, të tjerë tundnin kokat si të paralizuar e të sëmurë.

⁷ Shih: el-Alūsi, *Ruh el-Ma’āni*, vll. 2, f. 357; Hasan Ba Jodah; *el-Nādi el-Edebi el-Thakāfi*, Xhiddeh, 1992, ff. 549-551.

⁸ el-Busti, ff. 283-289; Ali el-Bajawi wa Akharūn, *Kaşaş el-Kur’an*, el-Maktabah el-Tijarijah el-Kubrā, Kajro, 1969, ff. 15-22. Shih edhe *Hūd*: 5, *el-Isra’*: 50-51.

6- Veç këtyre lëvizjeve të çuditshme të jobesimtarëve, siç u tha, figura dinamike e Kur'anit Famëlartë ka treguar durimin dhe përkushtimin e të dërguarve të Zotit në përballjen e tyre me braktisjen dhe shqetësimin nga ana e njerëzve, gjersa e vërteta vjen dhe e rremja zhduket. Ndaj, duhet të mësojmë sabrin dhe palëkundshmërinë nga të dërguarit e Zotit dhe t'i paralajmërojmë jobesimtarët përpara vdekjes. Zoti i Madhëruar ka treguar këtë figurë të mrekullueshme në vargjet e mëposhtme:

“Ai tha: ‘O Zoti im, unë e thirra vërtet popullin tim natë e ditë, por thirrja ime edhe më tepër i largoi (nga e vërteta).

Sa herë, që i thirrja për t'i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloreshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim).

Pastaj i thirra me zë të lartë. Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi.

(Nuh: 5- 9)

Lidhur me vdekjen,⁹ figura dinamike në Kur'anin Fisnik ka shpalosur funksione të shumta fetare, ku përmenden të mëposhtmet:

- 1- Shpirti i njeriut është në duart e Zotit, Ai e mban si të dëshirojë, kur të dëshirojë, si të dëshirojë, ku të dëshirojë.
- 2- Muslimani duhet të përpiqet sikur do të jetoj përgjithmonë, dhe duhet të përgatitet për ahiretin sikur do të vdesë nesër.
- 3- Nuk ka kohë për dëfrim, epshe dhe harrim të vdekjes.
- 4- Besimi në vdekje dhe ringjallje, shpërblim dhe dënim, Parajsë dhe Ferr.
- 5- Të pranuarit se besimtari nuk e njeh kohën e vdekjes së tij, si i vjen dhe ku i vjen.

9 Shih vargjet: *el-Zumer*: 32, *el-Nisa'*: 100, *el-Mu'minūn*: 99, *el-Ahzab*:16, *el-An'am*, 93; *el-Bakarah*: 243.

- 6- Gjumi konsiderohet vdekje e vogël, kështu që besimtari duhet t'i jetë mirënjohës Zotit pasi zgjohet.
- 7- Bindja në përcaktimin e Zotit; urdhri i Tij do të ndodhë dhe ekzekutohet e askush nuk mund ta ndalë.
- 8- Vdekjes nuk i iket dot, ajo është kudo që të jemi dhe nuk shtyhet dot e as nuk afrohet.
- 9- Muslimani duhet të përgatitet që të përballet me agoninë e vdekjes ngase ajo nuk është çështje e lehtë. Muslimanët ndeshen me vështirësi, halle dhe mndim kur ia dorëzojnë shpirtin e tyre Zotit.¹⁰ Po jobesimtarët atëherë!? Zoti na ruajtë. Këto realitete përmenden në këtë figurë të mrekullueshme kur'anore:

“Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!” Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: “Kjo është nga ana e Allahut”. Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: “Kjo është prej teje (o Muhamed)!” Thuaju: “Të gjitha janë prej Allahut”. Ç’është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?”

(en-Nisa’: 78)

“Thuaj: ‘Vdekja prej së cilës po ikni, do t’ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t’ju njoftojë ju për atë që keni bërë’.”

(el-Xhumu’ah: 8)

Disa ajete i referohen Ditës së Gjykimit:¹¹

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: ‘Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!’ Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës.”

10 el-Razi, vll. 5, ff. 2060-2061

11 Shih: Sejid Kutb, *Fi Zilāl el-Kur’ān*, Vll. 5, ff. 2560-2561.

(el-Furkan:27-29)

Atë ditë, asnjë mik, madje as më i afërti, nuk duhet dëgjuar. As fëmija as pasuria s'kanë dobi. Pishmanllëku për mëkatet nuk vlen. Mundësia dhe koha e faljes kanë kaluar. Do të ketë torturim, turpërim dhezjarr. Zullumqari nuk do të ketë asgjë përveçse kafshimin e thonjve të duarve dhe të jetuarit në pishmanllëk dhe pikëllim. Ai braktiset nga shejtani i tij, kështu që fajëson veten për fatin e tij. Ai as nuk ka ndjekur profet, as nuk ka braktisur mëkat. Shejtani ka qenë këshilluesi i tij i besuar dhe udhëzues i afërt në deluzion të qartë.

Disa ajete kur'anore japin një pamje të raportit të jobesimtarëve me Zotin e Madhërishëm. Kjo kryhet me lëvizje retorike dhe pohime shumë të shkurtra. Veprat e tyre janë të gabuara, të gjitha janë zhdukur, asgjë nuk ka mbetur; nuk ka dobi prej tyre. Ja cfarë thotë kjo figurë e qartë:

“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë. Aty do të hasë në dënimin e Allahut, i Cili ia paguan llogarinë e tij të plotë, se Allahu është i shpejtë në llogari. Ose janë si errësirat në detin e thellë, të cilat mbulohen nga dallgët që ngrihen njëra mbi tjetrën, duke pasur sipër tyre retë: shtresa errësire njëra mbi tjetrën, aq sa kur e nxjerr dorën e vet, njeriu pothuajse nuk e sheh fare atë. Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë.”

(en-Nur: 39-40)

Veprat e tyra janë bërë mashtrim, mohim, shpërhapje, mosbindje, mirazh i rremë, errësirë çulle, si valë vrastare dhe re shkreptuese. Ata nuk i udhëzon kurrfarë drite, asjë rrugë nuk i shpëton,¹² *“Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë.”*

12 Shih: el-Zamakhshari; *el-Kashshāf*, Vvll. 4, ff. 309-310; el-Tahir bin ‘Ashūr, *El-Tahrir wa el-Tanwir*, Vvll. 18, ff. 251-257.

Mjaft ajete kur'anore merren specifikisht me skenat e Ditës së Gjykimit.¹³ Ato shpjegojnë tmerret e asaj dite. Ajo është Dita e Njehjes, Dita e Ringjalljes, Dita e Grumubllimit, Dita e Tundjes. Gjithçka sheh dikush për atë ditë është e paimagjinueshme, e pabesueshme dhe gati e pamundur për syrin. Ja disa skena të ditës së tmerrit:

“Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin;

kur yjet të rrëzohen

dhe malet të lëvizin tutje;

kur devetë barrse të braktisen

dhe egërsirat të tubohen;

kur detet të vlojnë

dhe shpirtrat të bashkohen (me trupat);

kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet

për çfarë faji ishte vlarë;

kur fletët të shpërndahen³⁸⁹

dhe qielli të zhvishet;

kur Xhehenemi të flakërojë

dhe Xheneti të afrohet:

atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë). (et-Tekuir: 1-14)

Dhe Fuqiploti thotë:

“Kur qielli të çahet

dhe yjet të derdhen;

kur detet të përzihen

dhe varret të rrotullohen,

13 Shih: Sejid Kutb, Vvll. 6, p. 3846-3847; Also Shih vargjet: *el-Inshikāk*:1-6; *el-Waki'ah*: 1-6; *el-Zalzalah*: 1-6; *el-Kijāmah*: 6-13; *el-Mursalāt*: 7-13.

atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe ato që ka lënë pa bërë.”

(el-Infitar: 1-5)

Ajetet e sipërmendura përmbajnë mesazhe frenuese, frikësuese, premtuese dhe kërcënuese. Te kryerja e veprave të mira ka një përkujtim të qartë për besimtarin, sepse ajo ditë ëshë e gjatë. Ajo e bën njeriun të harrojë pasurinë, të afërmit dhe familjen. Zoti thotë:

“Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë.”

(Abese: 37)

Gjithashtu, këto vargje e paralajmërojnë besimtarin dhe mohuesin e begative të Zotit. Ato i kujtojnë atij skenat tmerruese të Ahiretit dhe tipin e dënimit që këta njerëz mund të ndeshin.

Kështu, nevojitet soditje e thellë e kuptimeve të ajeteve të mësipërme. Këto domethënie i njoftojnë njerëzit t’i qëndrojnë larg ndjekjes së gjurmëve të shejtanit, ngase pasimi i tij është rrënim, humbje dhe në fund dënim dhe torturë e zjarr. Në ahiret njerëzit do të jenë pishman, në çregullim, dhe do ta pyesin veten:

- Ç’është përgatitur për atë ditë?
- A do të falen?
- A do t’u pranohen veprat?
- Cili do të jetë vendi i tyre përfundimtar?

Parabolat në Kur’anin Fisnik janë shumë të rëndësishme për udhëzim e drejtim. Ato janë edhe më ndikuese në ilustrim, e nëse shoqërohen me figuracion dinamik, konfirmojnë dhe sqarojnë edhe më tepër. Kjo mund të shihet tek shembulli i mohuesve të Zotit që adhurojnë idhuj.¹⁴ Ata kërkojnë strehë te këta idhuj me kërkesa, u veshin aftësinë për të vepruar, kështu që lutjet e tyre janë në deluzion. Kjo i ngjan një personi që ka nevojë për ujë. Kur arrin burimin, zgjat krahët, fut duart e hapura në ujë dhe hedh ujë drejt

14 Shih: el-Rāzi, Vwll. 10, ff. 29-30; el-Bajanūni, ff. 34-41; *Ahamijatu el-Mathali fi el-Kur’ān*; Ibn Tejmijeh, ff. 231-239.

vetes për të pirë. Me duar të hapura kështu ai nuk pin dot. E njëjta vlen edhe për ata që adhurojnë tjetër veç Zotit. Këta idhuj nuk u ofrojnë dot as ndimë e as dëm. Të shohim ilustrimin e mahnitshëm kur'anor më poshtë:

“Vetëm për Atë është lutja e vërtetë! Kurse idhujt, të cilëve jobesimtarët u luten në vend të Allahut, nuk u përgjigjen lutjeve të tyre aspak. Rasti i tyre është si rasti i atij që i zgjat duart tek uji, për t'i ardhur te goja, por ai kurrsesi nuk i vjen. Lutja e jobesimtarëve është e kotë.”
(er-Ra'd:14)

Ata që synojnë prestigj dhe nder nga tjetërkush pos Zotit të Madhërishëm do të poshtërohen prej Tij. Ata që i kërkojnë tjetërkujt do të çnderohe dhe turpërohen. Zoti i Madhërishëm thotë në Kur'anin Famëlartë:

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!”

(en-Naml: 62)

Ajete të tjera rikonfirmojnë se udhëzimi vjen vetëm prej Zotit dhe kontrolli i gjithçkaje është në duart e Tij.¹⁵ Allahu thotë:

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.”

(el-En'âm:125)

Atij që i jepet begati nga Zoti, duke u përpjekur për takimin me Të, me dëshirën për ta dashur Zoti dhe sinqeriten në adhurim, Zoti ia zgjeron kraharorin drejt udhërrëfimit, pra Islamit. Zoti jep gjithashtu gjithçka të mirë dhe e vetëdijëson robin për këtë. Kjo ia lehtëson rrugën e dijes dhe e frymëzon me dritën e imanit të vërtetë dhe të tejdukshëm. Prej atij që i

15 Shih: el-Rāzi, Vwll. 13, ff. 186-195; Tāhir bin Ashūr, Vwll. 6, ff. 57-61.

humbet shpresat dhe pritshmëritë të Zotit nuk pritet asgjë dhe nuk ka këshillë që ta kënaqë. “Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.”

(el-En’âm:125)

Nëpërmjet disa ajeteve, figura dinamike e zgjatjes ose tërheqjes së dorës tregon një metonimi dinamike në formën e bujarisë ose koprracisë. Këto dy cilësi nuk mund të jenë të pranishme tek i njëjti person.¹⁶ Po çifutët atëherë, që i veshën Zotit të tyre shtrënim të dorës, sikur Ai nuk jep e nuk shpenzon kurrë?

“Hebrenjtë thonë: “Dora e Allahut është e shtrënguar.” Iu lidhshin duart atyre dhe qofshin të mallkuar për atë që thonë! Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura. Ai dhuron dhe jep si të dojë. Ajo që të është shpallur ty (Muhamed) nga Zoti yt, me siguri që shumicës prej tyre do t’ua shtojë mosbindjen dhe mohimin. Ne kemi futur ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje deri në Ditën e Kiametit. Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, Allahu e shuan atë. Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në tokë, por Allahu nuk i do ngatërrestarët..”

(al-Ma’idah: 64)

“Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”

(al-Dharyât: 58)

Në dorën e Tij është pushteti, Ai e menaxhon si dëshiron. Ai ushqen krimbin në tokë, zogun në pemë, fetusin në mitër, balenën në errësirën e oqeanit. Ai është i lartësuar, Ai e rrit dhe e mpak furnizimin si dëshiron dhe kjo mbështetet në urtinë e Tij hyjnore dhe përfitimin shpirtëror të njeriut. Kur Zoti i ofron shërbëtorit të vet furnizim dhe ai e harxhon për kënaqësinë e Zotit duke e falënderuar Atë për bekimin, i Madhërishmi i jep edhe më shumë dhe e udhëzon atë. Mirëpo, nëse shërbëtori është koprac tamahqar dhe e mban veten për të vetëmjaftueshëm, Fuqiploti do ta poshtërojë dhe turpërojë.

“Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit). Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën

16 Shih el-Rāzi, Vvll. 6, ff. 43-48; Kutb, vvll. 2, ff. 929-930.

drejt shpëtimit. Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm, dhe e quan gënjeshtër më të bukurën (besimin), Ne do t'ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit”?

(el-Lejl: 5-10)

Disa shërbëtorë të Zotit privohen nga pasuria dhe bollëku. Kjo varet në urtinë e Zotit të cilën e njeh Ai. Zoti e di adhurimin e tyre nëse janë të varfër dhe nevojtarë. Ata e falënderojnë dhe e përmendin Allahun. Xhenneti është shpërblimi për durimin e tyre. Nëse i bën të pasur, kjo mund t'i çojë në braktisjen e adhurimit të Zotit. Si rrjedhojë, te varfëria ka bekim dhe nderë për ta, kurse për të tjerët jetesa në luks ka zemërim dhe mosmiratim.

“...Allahu di ta dallojë keqbërësin prej mirëbërësit...”

(el-Bekare: 220).

Megjithatë, kjo është sjellja e çifutëve; trazim, mashtrim dhe lakmi për pasuri e pronë.

Pohimi i tyre naiv për Zotin, se: *"dora e Zotit është e lidhur"* ishte për një arsye të caktuar në zemrat e tyre, por ata nuk ia dolën. Mirëpo, Zoti ua ka prishur planet duke i kthyer kundër vetë atyre. Kështu që atyre u mbetet turpërimi në këtë botë dhe tjetrën.

Përmes zgjatjes dhe tërheqjes së dorës, jepet një rrjedhim tjetër fetar duke përdorur figuracionin dinamiksiç paraqitet më poshtë:

“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë.

(el-Ma’ideh: 27-28)

Konteksti i këtij tregimi dinamik është vrasja, e cila sigurisht përbën krim të madh e të tmerrshëm. Ajo që e bën atë edhe më të madhe është fakti

se ka ndodhur mes dy bijve të Ademit (paqe pastë mbi të).¹⁷ Kjo figurë dinamikë përmbledhet nënjë mënyrë të përmbledhur retorike përmes metonimisë së krimit të madh e më të shëmtuar ndër njerëz – vrasja e të pafajshmëve, e cila ndalohet rreptësisht nga Zoti. Pejgamberi ynë i dashur Muhammedi a.s. na ka treguar për rëndesën e këtij krimi. Shuajtshmeria e kësaj bote është shumë më e lehtë në sytë e Zotit sesa vrasja e një njeriu të pafajshëm. Ja përse Zoti ka urdhëruar shpagim për rasjen, dhe Ditën e Gjykitimit vrasësi do të jetë në zjarr, ç'vëndqëndrim i keq. Zoti ka thënë: “*Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të).*” (*al-Ma'idah: 45*). Ky ishte krimi i parë dhe më i madh i kryer mbi tokë. Shpërblimi është i barabartë me llojin e veprimit që është zjarri për zullumqarët.

Figuracioni i përsëritur dinamik i njeriut që nuk adhuron dhe nuk e kujton Zotin thekson një tjetër funksion fetar. Nga ky funksion mund të mësojmë që lëndimi i dikujt, pavarësisht nga përmasat, pasqyron natyrën e krijimit të lënduesit dhe dalldisjen e tij. Ai nuk e kupton se si i vijnë gjërat e mira. Ky është modeli i njeriut që mund të gjendet kudo dhe kurdo. Ai është përherë në gjendje ankthi, mosrehatie dhe frike. Pyet shumë, punon pak, shpejton të përfitojnë, bëhet pesimist dhe i dëshpëruar kur i bjen e keqja. Nuk i frikësohet Zotit të vet. Ai e lavdëron dhe adhuron atë kur shë në telashe dhe fatkeqësi, kur lutet përulësisht dhe e kujton Zotin e vet pareshtur, duke pritur faljen e Tij vazhdimisht. Ai nuk i kujton bekimet e Tija në çaste dhe pozicione të ndryshme: shtrirë, ndenjtur dhe në këmbë. Kur Zoti i Mëshirshëm e largon fatkeqësinë, ky njeri bëhet arrogant sikur të mos i kishte ndodhur asgjë. Ai jeton në luks dhe rehati, e harron Zotin e tij, dhe shpërfill lutjen ndaj Tij. Ai bëhet si shejtani i mallkuar¹⁸ pas të qenurit ndër lavdëruesit e Zotit:

“E, kur njeriun e gjen e keqja, atëherë Na lutet shtrirë ose ulur, ose në këmbë. E, sapo Ne ia largojmë të keqen, vazhdon rrugën, thuhet nuk Na

17 Shih: el-Kurtubi, Vll. 6, ff.133-138; Ibn Kethir; *Kasas el-enbijā'*, ff. 33-38; el-Suhajbāni, Abd el-Muhsin, *el-Fitnatu wa Mawkif el-Muslimin minhā fi Dav'i el-Kur'ān*, Dar el-Kasim li el-Nashr, Rijad, 1996, p. 166.

18 el-Kurtubi, Vll. 10, p. 321.

është lutur për fatkeqësinë që e ka goditur. Kështu, plëngprishësve (që shkelin kufijtë e Allahut) iu zbukurohet ajo që punojnë."

(Yûnus: 12)

Çdo musliman duhet të bëjë shumë kujdes që të mos numërohet mes të tillëve ngase ata janë më të urryeshëm se gurët që shkelen nga njerëzit. Çdo musliman duhet të nxitojë në pendesë dhe keqardhje për gabimet e bëra. Zoti di gjithçka dhe thotë:

"Pa dyshim, Allahut nuk i fshihet asgjë në Tokë dhe as në qiell!" (Âl-i 'Imrân:5).

Figura dinamike në ndodhinë e Jusufit a.s. me gruan e Faraonit el-Aziz¹⁹ pohon se Zoti është gjithmonë me të devotshmit dhe të drejtësishmit, si dhe me të dërguarit dhe profetët e Tij. Kushdo që ndjek rrugën e drejtë, që është i ndershëm dhe i dëlirë, i lutet Zotit të vet dhe arrin faljen dhe ndihmën e Zotit në fund, duke qenë mes atyre që do të shijojnë lumturinë e hirit të Tij. Ky varg tregon se Zoti i madhërisëm do t'i ndihmojë ata që i binden. Po ashtu, ata që janë të ndershëm dhe i largohen krimit të imoralitetit – edhe kur kanë rast për ta bërë – do të shpërblehen me një mbrojtje të veçantë Ditën e Gjykimit. Transmetohet nga i dashuri ynë Profet Muhammed (paqe dhe bekime pastë mbi të)²⁰: "...dhe një njeriu që ftohet nga një zonjë e bukur dhe me pozitë për të kryer imoralitet i thotë asaj se i druham Zotit është si Jusufi a.s. dhe ata që ndjekin gjurmët e tij.

Figura dinamike në ngjarjen e Jusufit a.s. nënvizon faktin se fitorja u takon të përzotshmëve dhe të drejtësishmëve, si dhe që pejgamberët e të dërguarit e Zotit do t'i ekspozohen shumë sprovave. Megjithatë, përmes imanit të fortë, vendosmërisë së lartë dhe energjive të plota, ata ngadhënjejnë. Në kohë vendimtare krizash kur janë thuajse të shterrur dhe pranë humbjes, atyre u vjen ndihma dhe fitorja e Zotit. Kjo ua forcon zemrat

19 Shih: el-Rāzi, Vwll. 18, ff. 115-128; el-Sūjūti, *el-Durr el-Manthūr fi el-Tafsir bi el-Ma'thūr*, vll. 8, ff. 219-232; Abd el-Hafez, el-Sejid; *Būhūth fi Kasas el-Kur'ān*, Dar el-Kitāb el-Lubnāni, Beirūt, 1972, ff. 191-209; Ali Al Bajāwi wa el-Akharūn; *Kasasu Al Kur'ān*, ff. 90-98.

20 Ibn Hajar el-'Askalāni, *Fat'h el-Bari' fi Sharh Sahih el-Bukhāri*, Vwll. 19, p. 226.

dhe këmbët. Ajo që i bën profetët dhe të dërguarit të ndryshëm nga të tjerët është përpjeka e tyre e pareshtur për t'i kapërcyer sprova të tilla.²¹

21 'Abd el-Kārim el-Khatib, *Kis'satā Adam wa Jusuf - Alajhima el-Salam*, Dar el-Fikr 'Arabi, Egjpt, 1973, p. 79. Shih also: el-Ansāri Abu Hafs, *Zuhr el-Kimām fi Kis'sati Jusuf Alajhi el-Salam*, Dar el-Kutub el-'Ilmijah, Beirūt, 2003, ff. 193-4; Also, 'Omar Ba Hadhek, *el-Dilalatu el-I'jazijah fi Rahab Surati Jusuf*, Dar El-Ma'mūn li el-Turāth, Damascus, ff. 23-28.

KREU II**Funksioni psikologjik**

Kur'ani Fisnik është një libër jete dhe feje, që i drejtohet njerëzimit në perceptim dhe mendim. Ai i parashtron gjithashtu njerëzimit gjurmët e të bekuarve dhe shtegun e sigurtë. Kur'ani shqyrton shpirtin njerëzor dhe e larton atë. Për rrjedhojë, zemra qetësohet, shpirti pastrohet, njerëzit i bashkohen njëri tjetrit në lumturinë e tyre dhe ndajnë pikëllimin dhe shqetësimin ë bashku; ata e thërrasin Zotin e tyre me besim dhe dije të plotë. Kjo thirrje ua shkrifëton zemrat dhe ua lartëson frymën njerëzve; kështu që shpirtat njerëzorë i kthehen Zotit të tyre të kënaqur.

Kur'ani Famëlartë po ashtu vështron edhe shpirtin vetëqortues dhe e motivon atë për mirë. Ko nënkupton reformimin e tij, dëlirjen e tij nga emocioni dhe ndjenjat, për t'ia hequr të keqen që mund ta pengojë nga qetësia dhe dëlirja, si dhe për ta ruajtur nga rrugët e dyshimta dhe privimi. Ndaj, shpirti vetëqortues i kthehet mbrojtjes së Zotit të vet i dëlirur nga mëkatet, i qetë dhe i qëndrueshëm, duke shquar të mirën nga e keqja.

Kur'ani Fisnik shqyrton po ashtu edhe shpirtin që nxit për keq dhe e kufizon atë nga keqbërja dhe rrugët e dyshimta. Kjo nënkupton të ftuarit e tij në rrugët e parajsës dhe të përkujtuarit e tij për metodat e pendesës dhëmëshirës. Nëse ky lloj shpirti nuk u përmbahet urhdëresave të Zotit, do të jetë tepër vonë në kohën e vdekjes për t'u penduar dhe ai do të jetë mes banorëve të zjarrit. Për shkak të refuzimit dhe mohimit të vazhdueshëm të paralajmërimeve të Zotit prej tij dhe distancimit nga besimi, ai do të jetë gjithmonë në gjendje verbërie dhe joshjeje, dhe do të hidhet në humbje. Asnjë ndërmjetësues nuk do ta ndihmojë dhe asnjë shpërblim nuk do t'i jepet. Do të ketë turp dhe poshtërim, torturë dhe zjarr për shkak të arrogancës së tij kur ishte gjallë, dështimit për t'i përmbushur urdhëresat e Zotit, dhe largimit nga Kur'ani Fisnik që është plot premtime e kërcënime me shenja të qarta e të sigurta. Mirëpo Zoti ynë nuk është kurrë i padrejtë ndaj shërbëtorëve të Tij.

Përmes figurace dinamike në shumë ajete, Kur'ani Famëlartë arrin ta nxisë shpirtin njerëzor dhe t'ia stimulojë emocionet sidomos në vargje që përmbajnë premtime dhe kërcënime. Kur'ani Fisnik i paraqet pamjet e Ditës së Gjykimit. Ai përshkruan edhe adhuruesit që e kujtojnë Zotin gjatë natës dhe në fund të ditës, duke ilustruar gjithashtu figura të tjera dinamike të shpirtit njerëzor. Funksionet e tyre do të paraqiten me ajetet përkatëse.

Në disa vargje të tjera kur'anore, Zoti Fuqiplotë parashtron kënaqësinë dhe devotshmërinë, tolerimin shpirtëror, zgjerimin e vizionit, dhe ndreqjen e opinionit për ata adhurues që e përkujtojnë. Kështu, zemrat e tyre dëliren dhe mendjet e tyre drejtohet. Ata besojnë në kadanë dhe kaderin nga Zoti, e kuptojnë rëndësinë e të qenit i singertë në adhurimin e Zotit dhe zemrat e tyre i përkushtohen Atij. Ata nuk kanë urrejtje, antagonizëm, xhelozitë dhe lakmi, por vetëm kënaqësi, tolerancë dhe pastërti shpirtërore. Ata janë zotërues të shpirtit të paqëtur.²² Zoti thotë:

“Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Âl-i ‘Imrân: 191)

Dhe po ashtu thotë:

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!’” (ez-Zumer: 9)

Disa nga ajetet me figura të ngjashme dinamike janë edhe këto:

“Sikur t’i shohësh keqbërësit se si para Zotit të tyre kokulur do të thonë: “O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena (në atë botë) që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!”” (es-Sexhdeh: 12).

Kjo na mundëson të nxjerrim një pamje më të plotë, që na zbulon domethënie e përfytyrime të reja. Kjo është gjendja e vërtetë e politeistëve kur dënohen, duke jetuar në turp të madh dhe keqardhje të madhe për ç’kanë vepruar. Kur'ani Fisnik e zëvendëson krejt skenën me një figurë të vetme

22 Shih: el-Tabari, vll. 4, ff. 209-210; Ibn Tejmijeh, *Mekārim el-Akhlak*, ff. 193-201.

dinamik në një situatë të veçantë, duke thënë "...kokulur..." Kjo tregon ankthin e tyre për ç'kanë vepruar dhe u zbulon njerëzve shumë kuptime që nuk konceptualizohen dot me fjali të gjata.²³

Gjithashtu, në disa ajete të tjera, figura dinamike demonstroi gjendjen që e kaplon atë që kryen mëkate ose krime. Ai nuk ndjehet kurrë i qetë, nuk flen e nuk rri në një vend, sepse nuk i di pasojat që mund t'i vijnë nga mëkati. Tërë kohës, ai pret dënim dhe shpagim. Zemra e tij dridhet vazhdimisht duke kujtuar atë që ka vepruar. Ai është i dëshpëruar dhe sytë i shohin përrotull në gjendje frike; të gjitha shqisat i ka në frikë dhe tronditje të vazhdueshme. Zoti thotë:

"Teksa Musai ecte në mëngjes i frikësuar në qytet, duke pritur se ç'do të ndodhte, kur ai që të djeshmen e kishte thirrur në ndihmë, e thirri sërish në ndihmë. Musai i tha: 'Ti qenke tamam një ngatërrestar i hapur!'" (el-Kasas:18)

Zoti thotë gjithashtu:

"Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç'do të ndodhte dhe tha: 'O Zoti im, më shpëto prej popullit keqbërës!'" (el-Kasas: 21)

Ky ajet tregon rëndësinë e durimit dhe faljes në kohën e zemërimit dhe tmerrit duke e vënë besimin e tyre te Zoti. Allahu thotë:

"...të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit." (Âl'-i Imrân: 134)

Kebërësi, përkundrazi, do të ketë reagim të shpejtë, iman të dobët, mendje konfuze, zgurdullim të syve, dhe trazim shqisash.

Kjo figurë dinamike shfaqet në mënyrë të njëpasnjëshme dhe me intensitet në një ajet që përshkruan zullumqarët:

"Mos mendo kurrsesi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe, duke vrapuar me kokë lart, nuk do të

23 Abd el-Halem Hafni, *Uslûb el-Sukhrijati fi el-Kur'ân el-kerim*, ff. 118-119.

mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri)."

(Ibrâhîm: 42-43)

Ky ajet sjell katër figura të njëpasnjëshme dhe të shoqëruara. Me fjalë të tjera, katër skena të njëpasnjëshme për një rrëfim. Ato figura krijojnë një pamje të skalitur në imagjinatë. Vërtet, kjo është një tablo unike në portretizimin e tmerrit, turpit, frikës dhe nënshtrimit të plotë. Ai mbulohet nga një hije shtypëse dhe trishtuese. Gjendja e tablosë ka dy grupe; njëri është vetë pamja, tjetri zbulohet prej saj. Ata janë njerëz që kanë një lidhje të përbashkët dhe një ndjesi të ngjashme. Këto figura bëhen të gjalla në grup, i cili shpalos një ndjenjë emocionale mes dy grupeve në një mënyrë shpirtërore me imagjinatë të prekshme. Kur lexuesi lexon ajetin, ai ndjehet në mënyrë të ngjashme mendërisht dhe shpirtërisht, sikur të ndodhej në situatë të njëjtë.²⁴

Figurat dinamike në ajetet kur'anore që kanë të bëjnë me vdekjen²⁵ paraqesin një sërë treguesish domethënës psikologjikë. Ata e ndikojnë shpirtin e besimtarit kur i lexon këto ajete. Ai bëhet më reflektues dhe i devotshëm, i druhet Zotit dhe dënimit të Tij në Ditën e Llogarisë. Kështu, ai bëhet më aktiv dhe i pendohet Zotit:

"Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!" Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: "Kjo është nga ana e Allahut". Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: "Kjo është prej teje (o Muhammed)!" Thuaju: "Të gjitha janë prej Allahut". Ç'është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?" (en-Nisa':78).

Dhe Ai shpall: *"Thuaj: "Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë ju për atë që keni bërë.""*

(el-Xhumu'ah: 8)

24 Kutb, *el-Tasvir el-Fanni*, p. 51; tw shihet edhe Ibn Tejmijeh, *Mekārim el-Akhlak*, ff. 283-289.

25 Shih: el-Basti, *Rawdatu el-'Ukala'*, ff. 283-289. Referoju edhe: *el-Zumer*: 42; *el-Nisa'*: 100; *el-Mu'minūn*: 99; *el-Ahzāb*: 16; *el-En'am*: 93; *el-Bekareh*: 243.

Njeriut do t'i pëlqente të jetonte në këtë botë përgjithmonë dhe ai i druhet vdekjes edhe në qoftë vetëmohues. Ai nuk e di se ku do ta shpiejnë veprimet e tija. Ai e pret vdekjen gjithnjë dhe ka frikë prej saj. Mirëpo gatishmëria për vdekjen varet nga forca e imanit. Ata që e kanë shpirtin dhe besimin të fortë dhe të kënaqur janë përherë aktivë, rendin në pendim dhe luten gjithë kohës. Ata që janë të zënë me lukset dhe dëshirat e jetës janë gjithnjë në ankth dhe të hutuar dhe i druhen vdekjes tamam si përpara fundosjes. Kësisoj, ata merakosen për këtë jetë dhe mnd ta harrojnë ahiretin gjersa të ndeshen me vdekjes e fuqishme që vjen papritur. Dhe atëherë nuk kanë ku shkojnë!

Të gjitha figurat dinamike të mësipërme sjellin në zemrën e mohuesit gjendjen e frikës dhe mosrehatisë. Ato mund ta çojnë atë në pendesë dhe ta sjellin më pranë Zotit të tij përpara se të jetë tepër vonë, sepse ai nuk e di nëse do të mbetet gjallë apo jo çastin e ardhshëm. Për besimtarin, këto figura janë shumë të dobishme. Ai mendon për vdekjen dhe e kujton atë. Ai i pendohet Zotit të vet dhe është i gatshëm të ndeshet me vdekjen sikur ta kishte përpara syve dhe sikur Dita e Gjykimit të ishte pas pak: ose parajsë ose ferr.

Në ajetin fisnik:

"Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhentë e mburracakët!"

(Lukman: 18)

nëpërmjet një figure dinamike, Kur'ani Famëlartë arrin ta çojë shpirtin në një tablo të shëmtuar dhe neveritëse. Kur'ani e portretizon tablonë e një njeriu krekosës dhe arrogant, i cili ec me kapardi, kthehet mënjane nga njerëzit, duke u fryrë dhe krekosur. Kjo paje e shëmtuar krahasohet me një deve qafështrembër, e cila nga sëmundja përdredh qafën, duke mos mundur të ecë drejt nga qafa. Ajo ecën shtrembër dhe e tundur. E tillë është edhe pamja e njeriut krekosës, arrogant, që mënjanohet nga njerëzit. Me këtë sjellje të shëmtuar njeriu bëhet objekt talljeje e sarkazme, dhe nuk ka njeri që, pas leximit të këtij përshkrimi, dëshiron të ecë njëlloj si arrogant, me

krekosje, duke e mbajtur veten superior. Kështu pra, askush nuk e pranon këtë lloj përshkrimi për vete, ose dëshiron ta përvetësojë këtë lloj ecjeje.²⁶

Në stilin e stilit hyjnor të Kur'anit Fisnik, shpalosja dhe çmaskimi i qëllimeve të brendshme të hipokritëve, të cilët përpiqen fort për të përhapur fitne mbi dhe, për ta cenuar bashkësinë islame, bëhet i plotë. Idetë dhe planet e tyre dalin sheshit, shpresat e tyre shpërhapen. Kur'ani Fisnik ia ka shpallur Profetit tonë të dashur disa prej sjelljeve të tyre, si p.sh.:

“Kur frikësohen, ata të shikojnë ty (o Muhamed) për ndihmë, duke i rrotulluar sytë sikur të ishin në agoni. Por, sapo t’u kalojë frika, ata ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë dhe janë koprracë me ju për çfarëdo të mire. Këta janë ata që nuk kanë besuar, andaj Allahu i ka asgjësuar veprat e tyre. E, kjo për Allahun është lehtë.”

(el-Ahzab: 19)

Në skenat e mësipërme, Kur'ani i ka theksuar lëvizjet e tyre duke iu drejtuar ndërkaq të Dërguarit të Zotit a.s., në një mënyrë plot tallje dhe sarkazëm, dhe atë që u ndodh atyre kur shpirtrat, shtëpitë dhe pronat e tyre janë në rrezik, dhe në këtë çast vendimtar mund të dallojmë mes njerëzve të singertë dhe të rremë.

Në këtë figurë dinamike Kur'ani e ka treguar frikën dhe shqetësimin e tyre në një fjali të vetme: "Sytë e tyre rrotullohen." Si çfarë? "Si ai që është në agoni." Me këtë ilustrim Kur'ani Fisnik ka theksuar pikat kryesore të dobëta që ndodhen në zemrat e hipokritëve, si: dashuria ndaj kënaqësive të botës, mosgatishmëria për mbrojtjen e fesë islame, pa sakrifikuar për të as pasurinë, as fëmijët, as pronën. Me anë të kësaj figure të mrekullueshme dinamike, Kur'ani është në gjendje të na e tregojë shkurtimisht gjendjen e tyre mendore, personalitetin dhe karakterin, që nuk do të përcillet me fjalë e përshkrime të shumta.²⁷

26 Abdul-Halim Hafni, *Uslūb el-Sukhrijati fi el-Kur’ān*, p. 58; Kutb, *Fi Zilāl el-Kur’ān*, vll. 5, p. 2790; Ibn Tejmijeh, *Mekārim el-Akhlak*, ff. 225-230; el-Busti, *Rawdat el-‘Ukala’*, ff. 59-62; Hasan Ajūb, *el-Sulūk el-Ixhtima’i*, ff. 432-433.

27 Shih ‘Abd el-‘Aziz el-Humajdi, *el-Munāfikūn fi el-Kur’ān*, ff. 214-230.

Kur'ani Fisnik i përmend shpesh skenat e Ditë së Gjykimit,²⁸ me qëllim nxjerrjen e mësimëve, meditimeve dhe depërtimeve shpirtërore, përpara se të jetë tepër vonë. Kështu, kur i lexojmë vargjet e lidhura me Ditën e Gjykimit, mund të vërejmë drejtpërsëdrejti ndikimin e idesë së ndëshkimit të Zotit mbi vetet tona. Përshkrimi i skenave dhe pamjeve të Ditës së Gjykimit është shumë i rëndësishëm; ai bën që të na rrjedhin lotët, na i trondit mendjet, na i dridh zemrat, na bën të psherëtimë. Njerëzit mblidhen. Si do të dukej nëse një nënë do ta braktiste foshnjën e vet dhe do të largohej; çdo shtatzënë do ta lëshonte barrën e vet, duke u larguar nga prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët?

“Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë.”

(Abese: 37).

Zoti Fuqplotë thotë:

“Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t’i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.”

el-Haxh: 2

Kur vështron poshtë, ai frikësohet edhe më tepër; kur sheh lart bëhet skajimisht me ankth. Cilat janë pra rrjedhojat e këtij tmerrri mbi besimtarin? Dhe çfarë mund të bëjë ai në atë ditë të frikshme? Atë ditë trupi do të dridhet, dhe lotët do të bien, kurse zemra do të rrahë më fort. Zoti i Madhërishtëm thotë:

“Kur qielli të çahet dhe yjet të derdhen; kur detet të përzihen dhe varret të rrotullohen, atëherë çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe ato që ka lënë pa bërë.”

28 Shih Kutb, *Fi Zilāl Al Kur’ān*, vll. 4, f. 2408; el-Husajn Garnu, *Asalibu el-Tashwik wa el-Ta’ziz fi el-Kur’ān el-Karim*, ff. 181-3. Shih edhe ajetet: *el-Tekuir*: 1-14; *el-Inshikāk*: 1-6; *el-Uaki’ah*: 1-6; *el-Zalzalah*: 1-6; *el-Kijāmah*: 6-13; *el-Mursalāt*: 7-13.

(el-Infitar: 1-5)

Arabët e shkretëtirës i prisnin me durim pikat e shiut që ua ripërtërinin jetën dhe punën. Kjo figurë e mrekullueshme dinamike në Kur'anin Famëlartë është fiksuar nëpërmjet analizës shpirtërore të arabëve dhe raportit të tyre me shkretëtirën, dhe dëshirimin e ujit prej tyre. Nga ky portretizim mund të nxirret mësim, se i eturi duhet të përdorë mjetet e duhura për të arritur synimet e tija. Zoti Fuqiplotë thotë:

"Vetëm për Atë është lutja e vërtetë! Kurse idhujt, të cilëve jobesimtarët u luten në vend të Allahut, nuk u përgjigjen lutjeve të tyre aspak. Rasti i tyre është si rasti i atij që i zgjat duart tek uji, për t'i ardhur te goja, por ai kurrsesi nuk i vjen. Lutja e jobesimtarëve është e kotë." (er-Ra'd: 14)

Nëpërmjet këtij shembulli të goditur, figura dinamike e Kur'anit ka përcjellë marrëzinë e atyre që adhurojnë gurë dhe perëndi të rreme, dhe ka treguar se ata nuk do të marrin përgjigje. Kjo i ngjan shembullit të mësipërm të jериut që përdor mjetet e gabuara për të shuar etjen.²⁹

Një tjetër skenë figure dinamike në Kur'anin Famëlartë mund të shihet tek ajetet që tregojnë debatin mes banorëve të Skëtërrës, duke e shpalosur kështu personalitetin e brendshëm dhe gjendjen psikologjike të jobesimtarëve, pavarësisht nga rangu dhe pikëpamja e tyre. Atë ditë, secili prej tyre do t'i ekspozohet zjarrit, pa asnjë dyshim. Nuk ka më tallje, arrogancë, apo mohim. Dënimi tashmë ka rënë mbi ta dhe Zoti nuk është kurrë i padrejtë ndaj shërbëtorëve të Tij. Zoti i madhërishtëm thotë në Kur'anin Famëlartë:

"Dhe, kur të grinden në Zjarr, të dobëtit do t'u thonë eprorëve që madhështoheshin: 'Ne ishim ithtarët tuaj, ndaj, a mund të shmangni prej nesh një pjesë të dënimit tonë?' Ata që madhështoheshin, do të thonë: 'Të gjithë ne jemi në zjarr. Allahu tashmë i ka gjykuar robërit e Tij'. Dhe ata që gjenden në zjarr, do t'u thonë rojtarëve të Xhehenemit: 'Lutjuni Zotit tuaj që të na lehtësojë dënimin, qoftë vetëm një ditë'! Ata do të përgjigjen:

29 'Abd el-Halim Hafni, f. 143. Shih edhe 'Abdur-Rahman el-Jarbū', *el-Amthāl el-Kur'ānijah el-Kijasijah el-Madrubati lil-Ixhmān*, Islamic University, Madinah: 2003, ff. 58-59.

“Vallë, a nuk ju kanë sjellë të dërguarit tuaj prova të qarta?” Ata do të thonë: “Po, është vërtetë”. Do t’u thuhet: “Atëherë thërrisni për ndihmë!” Por thirrjet e tyre do të jenë të kota.”

(Ghafir: 47-50)

Kësisoj, ata janë në debat të vazhdueshëm dhe mospajtim të pafund. Cdonjëri prej tyre (arrogantëve) përpiket të fajësojë tjetrin, për të shpëtuar nga Zjarri. Mirëpo, kjo do të ishte e pamundur për ta; ata do ta shohin Zjarrin mu përpara tyre, në ta djathtën dhe në të majtën e tyre. Ata do të vrrasin për ndihmë, por thërritja e jobesimtarëve është e kotë. Ajo që paraqitet në këtë tablo për gjendjen mendore dhe shpirtërore të jobesimtarëve që mohojnë Zotin dhe të dërguarit e Tij, dhe atë që ndodh në mendjet e tyre gjatë debatit është një përskrim shumë i përpiktë. Ai na tregon për shpeshimin e rrahjes së zemrave të tyre, në ç’frikë dhe panik jetojnë, si u dridhen trupat me mësimë që i zgjojnë vërtet, këto vargje plot mrekulli të Kur’anit janë për ata që duan të meditojnë thellësisht rreth kuptimeve të tyre. Atë ditë, asnjë mik e asnjë ndërmjetësues nuk dëgjohet. Atë ditë gjithkush do të jetë tepër i zënë për t’ shqetësuar për të tjerët. Vdekja është e vërtetë dhe reale, kështu që njerëzit duhet të pregatiten për këtë Ditë, që të mos jenë mes atyre të cilët do të debatojnë me miqtë e tyre.

Sërish, figura dinamike e Kur’anit lidhur me zgjatjen dhe tërheqjen e dorës është përmendur disa herë, duke mbartur në strukturën e saj disa funksione. Mes tyre është shpërdorimi dhe koprracia. Këto dy dukuri kanë ndikime negative në shoqëri. Nëse dikush është shpërdorues, ai do t’i bëhet barrë shoqërisë, sepse duke i harxhuar të gjitha kursimet e tij do të detyrohet të lypë nga njerëzit, pasi nuk është në gjendje të vazhdojë jetën normale dhe ka humbur gjithçka. Përkundrazi, nëse dikush është koprrac, edhe ai bëhet i qortueshëm, sepse mbetet gjithmonë njeri pasiv, pa harxhuar asgjë, rri në gjendje shoku dhe frike, i shqetësuar për pasurinë e tij, i frikësuar nga vjedhësit e hajdutët, dhe druhet se të tjerët mund t’i kërkojnë gjëra. Në fund, ai mbetet në gjendje ankthi e frike të vazhdueshme.³⁰ Zoti i Gjithëmëshirshëm thotë në Kur’an:

30 Hafni, *Uslûb el-Sukhrijati*, p.184. Shih edhe: el-Busti, ff. 234-241.

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë. Me të vërtetë, Zoti yt i jep me bollëk e ia kufizon (riskun) kujt të dëshirojë; Ai i di dhe i sheh mirë robërit e Vet.”

(el-Isra: 29-30)

Kjo figurë mahnitëse dinamike e Kur'anit demonstroi qartë devijimin e paganëve nga udhërrëimi dhe nga adhurimi i Zotit, duke i qortuar dhe duke hedhur në zemrat e tyre një lloj terrori e paniku. Gjendja e tyre është e ngjashme me atë që bie nga qielli në tokë, dhe me të rënë në tokë zogjtë e kapin dhe era e flak tej.³¹ Zoti thotë:

“Përluni plotësisht para Allahut me sinqeritet, duke mos i shoqëruar asgjë Atij (në adhurim). Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.”

(el-Haxhxh: 31)

Kur'ani Fisnik konfirmon qortimin e vet për ata të cilëve u është dhënë dije në fe por të cilët i kanë kthyer shpinën asaj duke rendur gjurmëve të shejtanit. Kjo figurë dinamike i krahason njerëz të tillë me një qen i cili nxjerr gjuhën dhe pastaj ul kokën. Kjo pamje demonstroi turpërim dhe poshtërim të plotë të atij që i ka kthyer shpinën dijes së vet, si gjarpri që del nga lëkura e vet, dhe shejtani e ka bërë zap, duke e futur me të shmangurit. Sikur të donte Zoti ai do të ishte bërë ndër njerëzit e ditur, por aianoi ngakjo botë, preferoi kënaqësitë e saj dhe për këtë arsye Zoti e ka poshtëruar dhe çnderuar. Për shkak të gabimit të tij të rëndë, shembulli i tij është identik me atë të qenit, i ulët dhe i egër.³² Le t'i drejtohem kësaj fjale të Zotit në Kur'an:

“Tregoj atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh,

31 'Abd el-Fattah Lasheen, *el-Bajān fī Daw'i Asālib el-Kur'ān*, f. 43.

32 'Aeed Junus; *el-Taswir el-Xhemāli fī el-Kur'ān el-Kerim*, f. 139.

ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua këto ngjarje, në mënyrë që të mendojnë."³³

(el-A'raf: 175-176)

Në një ajet tjetër, figura dinamike paraqet mjaft qartë dhe përpiktazi gjendjen shpirtërore dhe mendore të njerëzve arrogantë, të cilët krekosen me pasurinë dhe fëmijët e tyre, thua se harrojnë që ndërprerja e furnizimit të tyre është në duart e Zotit. Dhe Kur'an i Fisnik përmend në ngjarjen e tij të famshme, një njeri që hyn në kopësht me krekosje, politeist dhe arrogant. Mirëpo, Zoti i jep atij një mësim, duke ia shkatërruar kopshtin krejtësisht, për shkak të mosmirënjohjes së tij:

"Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet) - e që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët -, dhe thërriste: 'Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!.'"

(el-Kehf:42)

Një tjetër figurë dinamike e dhënë në Kur'an flet për zullumqarin dhe shtypësin në kohën e llogaridhënies në Ditën e Gjykimit. Ai i thërret mikut të vet për ndihmë, si dhe shejtanit të vet, por nuk ka përgjigje. Në atë çast të vështirë, shenjat e pishmanllëkut, frikës dhe pikëllimit do t'i shfaqen në fytyrë. Për shkak të gjendjes së tij kritike ai do të kafshojë duart. Zoti Plotmëshirues e ka treguar këtë skenë me vargjet:

"Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: 'Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!' Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës."

(el-Furkan: 27-29)

33 Shih: Muhammed Ramadan el-Buti, *Manhaxhun Tarbawijun Farid*, Dar al Hikmah, Beirut, 2003, ff. 72-81; el-Bajānūni, ff. 109-111.

Kur'ani Fisnik e ka trajtuar shpirtin e njeriut nëpërmjet disa mësimëve dhe elementeve që e bëjnë të shqetësuar për mirëqenien e vet, duke pritur tmerrin dhe vdekjen në çdo çast. Kështu që ai duhet të mendojë me kujdes se nuk do të ketë ndihmues ose ndërmjetësues, dhe askush nuk përgjigjet për mëkatet dhe fajet e atij. Nuk ka kohë dhe arsye më për të qenë krenar dhe arrogant ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, ose për të ndjekur joshjen e miqve. Vdekja është shumë pranë dhe shpirti duhet të rendë drejt pendesës dhe të shohë përpara për të arritur kënaqësinë e Zotit në ahiret, dhe për të qenë afër të dërguarit të Tij përfundimtar Muhammedit (paqe dhe bekime pastë mbi të) në Xhennet.

KREU III

Funksioni socio-edukativ

1- Vargje të shumta të Kur'anit që merren me figura dinamike kanë theksuar shumë funksione shoqërore lidhur me udhëzimin edukativ, që i vlejnë së tepërmi shoqërisë. Këto dobi mund ta ndihmojnë shoqërinë të zhvillohet dhe funksionet në fjalë i lejojnë asaj të mbrohet nga disa sjellje shkatërrimtare, që mund të shkaktojnë kolapsin e moralit dhe etikës. Në fragmentet e mëposhtme, do të përpiqemi të demonstrojmë disa prej këtyre epërsive shoqërore dhe edukative, të iclat figura dinamike e Kur'anit Fisnik i ka portretizuar me shprehjet e ndryshme ndikuese.

Disa ajete kanë vënë në paj një dukuri shumë të rrezikshme dhe shkatërrimtare, që është përhapur shumë në disa shoqëri muslimane, pikërisht kamata. Zoti Fuqiptotë thotë në Kur'anin Fisnik:

“Ata që marrin fajde, do të ringjallen (në Ditën e Gjykimit) si ai që djalli e ka çmendur me prekjen e vet, sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria. Porse Allahu e ka lejuar tregtinë, kurse kamatarinë e ka ndaluar. Ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe fati i tij është në duart e Allahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë..”

(el-Bekareh: 275)

Figura dinamike ka treguar se ai që përfshihet në këtë mesele është si i godituri nga Shejtani, i paudhëzuar dhe i pasuksesshëm në rang, fjalë dhe punë.³⁴

34 Shih: el-Kurtubi, Vll. 3, ff. 348-370; el-Tabari, Vll. 3, ff. 101-104; el-Rāzi, Vll. 7, p. 91-100; el-Nisabūri, Vll. 7, p. 83; Abu Hajjan el-Tawhidī, *el-Bahru el-Muhit*, vll. 2, ff. 534-537; Kutb, Vll. 1, ff. 534-537; Zakarija Bashir Imām; *Usūl Al Fikr Al Ijtima'i fi el-Kur'ān el-Karim*, Maktabatu Rawai'u Magdalawi, Jordan, 2000, ff. 226-227; Ghajthā' Muhammad, *Dirasāt Tarbawijah fi Wahati el-Zilāl*, 1998, ff. 379-387, Medina; Muhammad el-Jamāl, *el-Akhlak wa el-Mu'amalāt fi el-Islām*, ff. 14-29.

Kur'ani Fisnik e ka lidhur idenë e kamatës me punën e Djallit. Ai e ndihmon dhe e inkurajon muslimanin që ta kryejë këtë veprim, duke e bindur me shumë justifikime të rreme, dhe muslimani beson se ky veprim është në rregull. Me të rënë në kurthin e kamatës dhe me t'iu rritur pasuria, ai nis e ndjen se ka rënë në krim, duke e kuptuar se pas këtij mëkati qëndron shejtani. Kurdo që përpiqet të dalë nga kjo grackë, Djalli e kthen mbrapsht. Pozita dhe lëvizja e njeriut të tillë si ajo e të rrahurit nga Shejtani.

Nëse ky person e analizon veten, do të shohë se çfarë dëmi i ka sjellë kamata. Njerëzit rreth tij janë shumë xhelozë rreth tij. Në vend që të ndihmojë nevojtarët, duke ua zgjidhur krizat financiare, ai i shfrytëzon me kamatë dhe harron thënien e të dashurit tonë Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): *Kushdo që dëshiron të shpëtojë nga Zjarri, t'ia lehtësojë barrën të pikëlluarit që jeton në varfëri.*³⁵

Në ngjarjen e Ademit dhe Havasë, dhe dëbimit të tyre nga Xheneti, kishte një paralajmërim të madh dhe ndikim te disa pika të dobëta të sjelljes njerëzore. Kjo dobësi vërehet nëpërmjet figurës dinamike pasi ata hëngrën nga pema e mallkuar, u ngatërruan, dyshuan dhe u frikësuan. Zoti i Lartësuar thotë:

“Kështu, ata të dy, (Ademi dhe Havaja), hëngrën nga ajo pemë e u ndërgjegjësuan për lakuriqësinë e tyre, prandaj nisën të mbulohen me gëthet e Xhenetit. Ademi nuk e zbatoi urdhrin e Zotit të vet, kështu që devijoi (nga rruga e drejtë).”

(Taha: 121)

Në këtë ngjarje, mësimi për t'u nxjerrë është se njeriu duhet të jetë durimtar e jo i ngutur. Nganjëherë nuk e dimë se çfarë fshihet në botën e gajbit, dhe nuk ia njohim urtinë ndalesës së diçkaje. Muslimi nuk duhet të ndjekë epshet dhe dëshirën e tij e përjetësisë, dhe duhet të jetë i vetëdijshëm për joshjen e djallit.³⁶ Kjo që u tha konfirmon rëndësinë e të qenit durues dhe bindjes ndaj urdhëresave të Zotit tonë, që janë plot me dobi për

35 Ibn Haxhar el-'Askalāni, vull. 6, f. 389.

36 Shih el-Rāzi, vull. 11, ff. 126-128; el-Tahir Bin 'Ashūr, *el-Tahrir wa el-tanwir*, Vull. 16, ff. 326-328; Ibn Kethir, *Kasas el-enbijā*, ff. 7-20.

njerëzimin, kështu që ai nuk duhet ta shtypë veten duke u ngutur. Zoti i Mëshirshëm thotë:

“...Ne asnjëherë nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi..”

(en-Nahl: 118)

Në ngjarjen e lartpërmendur, Djalli arriti ta vinte gishtin te disa pika të dobëta të njeriut; kështu, ai përdori dy mjete të rëndësishme: joshjen dhe provokimin. Ai e bëri këtë përmes këshillës së tij ndaj Ademit dhe Havasë, duke i bindur se është këshillues besnik dhe i sinqertë, dhe se u dëshironte më të mirën. Ai i nxiti të hanin nga pema e përjetësisë, duke u premtuar një mbretëri që nuk do të priset kurrë, dhe në fund u betua në Zotin. Nëpërmjet kësaj hileje, Djalli i frymëzoi ata t’i përngjiteshin kësaj jete tokëore, krahas dëshirës së tyre për t’u bërë dominues. Kjo mund të shihet në jetën tonë të përditshme tek armiqtë tanë dhe hipokritët, që pretendojnë se na ofrojnë ndihmë, këshillë dhe udhëzime, por në të vërtetë, por në të vërtetë ata nuk ofrojnë asnjë lloj ndihme. Përfundimi në ndodhinë e Ademit është se ai iu mosbind Zotit të vet, pjesët e tyre intime iu bënë të shfaqura. Arsyeja e tij nuk e ndihmoi veçse që të mbulohej me gjethet e Xhennetit në panik dhe frikë, sepse ishte i sigurt që dënimi po afrohej.³⁷

Ajete të tjera theksojnë përrulësinë. Maturia në ecje është moral i madh shoqëror islam. Kjo lloj ecjeje përmendet në Kur’an në kontekstin e meritave të personave të drejtësishëm. Zoti i Madhërishëm thotë:

"Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe qoftë!"."

(el-Furkan: 63).

Sa për euforinë, krekosjen dhe sidomos arrogancën, ato konsiderohen sëmundje që e kaplojnë njeriun, duke e bërë të shohë lart në qiell, me shpresën për të garuar me malet nga arroganca dhe fodullëkun e tij, duke besuar se është superior ndaj të tjerëve. Kjo mungesë vlerash etike dhe

37 Shih Rashed el-Barawi, *el-Kasas el-Kur’āni Tafisurun Ixhtima’i*, Dar el-Nahdati el-‘Arabijah, Egjipt, 1987, ff. 17-18.

morale i thyen ato lidhje shoqërore mes muslimanëve, dhe ko nuk lejohet në Islam, sepse sjell përçarje, mospajtim dhe urrejtje të ndërsjellë.³⁸ Zoti i Madhërishtëm thotë:

"Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve."

(el-Isra: 37)

Në parabolën e mësipërme mund të vërejmë se Kur'ani Fisnik përdor stilin e sarkazmës dhe talljes nëpërmjet figurës dinamike të këtij njeriu arrogant, që dëshiron të depërtojë tokën ose të kapë malet në lartësi. Arsyeja paskëtij stili është se Kur'ani synon të ndryshojë vlerat e këqija shoqërore, të metat dhe mangësitë që ndalohen. Për shembull, Kur'ani Fisnik ndalon vlerat negative etiko-morale të arabëve paraislamë si arrogancën dhe superioritetin. Kjo ide mund të shihet sot tek të rinjtë që ënden për dominim dhe epërsi. Për të arritur qëllimet e tyre ata ndryshojnë sjelljen e jashtme, duke përvetësuar etikë të ashpër dhe brutale. Me fjalë të tjera, ata bëhen arrogantë dhe keqdashës.

Mënyra në të cilën Kur'ani Fisnik ofron kurën për këtë sjellje negative shoqërore është shumë interesante. Ai nuk e shëron thjesht me fjalë apo ndonjë lloj kërcënimi, por ai përdor stilin e sarkazmës dhe talljes për të ngulitur në mendje se sa e shëmtuar dhe e keqe është kjo lloj sjelljeje. Duke demonstruar anën më të shëmtuar të kësaj sjelljeje, Kur'ani e bën këtë etikë të mos duket tërheqëse dhe interesante, diçka për t'u krenuar; përkundrazi i drejtohet sarkazmës dhe talljes së personit të përfshirë në të.³⁹

Disa ajete kanë treguar gjithashtu disa zakone negative shoqërore lidhur me diskriminimin e grave. Zoti i Lartësuar thotë:

"Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s'di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimin apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!"

38 Shih: el-Rāzi, vll. 20, ff. 312-313; el-Busti, ff. 59-62; Ajüb, *el-Sulūk el-Ijtima'i fi el-Islām*, ff. 69-71, 432-433; Ahmed Ibrahim; *el-Fadā'il el-Khulukijah fi el-Islām*, p. 250-257

39 Hafni; *Uslūb el-Sukhrijati fi el-Kur' ān*, ff. 57-58.

(en-Nahl: 58-59).

Figura dinamike ka treguar përmes këtyre vargjeve dikë që fshihet prej njerëzve për shkak të së keqes me të cilën është njoftuar. A është plot mllef e mërzi, fshehet nga njerëzit, si borxhliu, ose kriminel. Arsyeja e kësaj sjelljeje është se ai i druhet varërisë, nëse kujdeet për këtë foshnjë, si dhe ka turp të bëhet me vajzë, për shkak të zakoneve të këqija të pranishme në erën paraislame. Sipas arabëve paganë, të paturit vajzë konsiderohej e turpshme, fatkeqësi dhe skandal.

Kur'ani i portretizon lëvizjet e tija konfuze dhe plot frikë. Ta mbajë, ta edukojë dhe të kujdese për të me turp dhe poshtërim, apo ta varrosë të gjallë, për të qetësuar dhe kënaqur mendjen dhe zemrën e tij? Vërtet, i keq është vendimi i tyre.

Në Islam, gruas i janë dhënë shumë të drejta dhe privilegje, që nuk shihen në fe të tjera. Ajo konsiderohet partnere e barabartë e burrit. Ajo është nënë, motër, bijë, dhe bashkëshorte. Sa të pandërgjegjshëm janë për këto realitete!⁴⁰

Figura dinamike e Kur'anit në rastin e zgjatjes dhe tërheqjes së dorës ka paraqitur funksione të shumta, në varsi të kontekstit. Nganjëherë ajo mbart në strukturën e saj kuptime të ndryshme, sikurse të qenit koprrac dhe dorëshpuar. Nganjëherë ajo nënkupton vrasjen dhe të përmbajturit prej saj, ose si akuzimi i rremë i çifutëve kundër Zotit, se duart e Tija janë të tërhequra, dhe aj që ata fshehin në zemrat e tyre kundër Islamit dhe muslimanëve.

Islami ka vendosur bazë të rëndësishme edukative, me parime të shumta etiko-sociale. Islami u bën thirrje njerëzve të punojnë dhe të jenë të matur në harxhim.⁴¹ Ai konfirmon edhe se mbajtja e njerëzimit është në

40 Shih el-Sujūti, *el-Durr el-Manthūr*, Vll. 9, p. 63; el-Shawkāni; *Fat'hul Kadir*, Vll. 4, ff. 2263-4; Zakarijā Bashir Imām; *Usul el-Fikr el-Ijtima'i*, ff. 216-223.

41 Shih: Bin 'Ashūr, Vll. 15, ff. 84-86; Ibn Tejmijeh, ff. 96, 102, 202, 209; el-Husajn Garno, ff. 137-181; 'Abd el-Rahmān el-Nahlawi; *Usūl el-Tarbijati el-Islamija*, Dar el-Fikr, Damascus, 1983, ff. 31-33; Zakarija Bashir Imām, ff. 216-223; 'Abd el-Halim Hafnawi, p. 184.

duart e Zotit. Mirëpo, njerëzit duhet të ndjekin mjetet e duhura për ta arritur. Koprracia nuk e rrit pasurinë, ajo sjell urrejtje dhe xhelozë mes njerëzve, ndërprerje të lidhjeve shoqërore dhe familjare.

Shpërdorimi dhe harxhimi i pafre i dëmton individët dhe shkatërron aftësitë shoqërore. Ai i çon njerëzit gjithashtu në imoralitet. Dorëlëshimi nuk është vlerë e mirë. Edhe koprracia i bie ndesh shprehinë e drejtësishtme të besimtarin. Të dyja vlerat janë të pakënaqshme për Zotin. Kështu që matura është ndër mësimet dhe vlerat më të rëndësishme të Islamit. Ai e bën muslimanin të qetë e të udhëzuar në çdo hap që hedh, dhe ai ndërgjegjësohet për gabimet dhe shkeljet në punën dhe adhurimin e tij. T'i lexojmë me vëmendje këto ajete hyjnore:

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë. Me të vërtetë, Zoti yt i jep me bollëk e ia kufizon (riskun) kujt të dëshirojë; Ai i di dhe i sheh mirë robërit e Vet.”

(el-Isra': 29-30)

Një mësim tjetër mund të nxirret nga figura dinamike e zgjatjes dhe tërheqjes së dorës: paralajmërimi nga kryerja e krimit më të rrezikshmit ndër të gjitha krimet shoqërore, gjegjësisht vrasjes pa të drejtë të një njeriu. Ky krim e lëkund paqen dhe sigurinë e një shoqërie.⁴² Për të ruajtur paqe mes njerëzve, Islami ka vendosur ligjin e shpagimit, për t'i dhënë mësim çdo vrasësi.

Profeti ynë i dashur Muhammedi a.s. ka paralajmëruar gjithashtu ndaj pasojave të zemërimit, për të mos arritur mejdanin e luftimit me një kundërshtar, përndryshe edhe vrasësi edhe i vrari do të jenë në Ferr, sepse të dy kanë qenë të ethshëm të vrasin njëri tjetrin. Islami e ndalon vrasjen e muslimanit pa një shkak të drejtë (*apostasi, kurorëshkelje nga burri, dhe vrasje nga një burrë*), përndryshe ligji i xhunglës do të mbizotërojë në shoqëri, nëse nuk shtrëngohen nga besimi dhe parimet e tyre islame.

Rëndësia e figurës dinamike është parë qartë edhe në ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ofruan fli. Zoti i Madhërishëm e pranoi fliun e Habilit, por nuk e pranoi fliun e Kabilit, i cili pastaj u betua se do ta briste të vëllain Habilin.⁴³ Kur'ani e ka portretizuar këtë veprim përmes figurës dinamike të

42 Ibn Haxher 'Askalāni, Vwll. 20, p. 28; el-Busti, ff. 138-140.

43 Shih: el-Bajdawi: *Anwar el-Tanzil wa Asrār el-Ta'wil*, Vwll. 2, p.68.

zgjatjes së dorës. Habili ishte njeri shumë i paqtë, por nuk e zgjati dorën për të vrarë të vëllain, sepse i druhej mëkatit. Le të lexojmë me kujdes këto vargje të Kur'anit Fisnik⁴⁴:

“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras”. Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë. Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndëshkimi i keqbërësve”. Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit.”

(el-Ma'ideh: 27-30)

Bukuria e figurës dinamike në zgjatjen dhe tërheqjen e dorës ka treguar shkeljen e çifutëve kundër Zotit dhe Atributeve të Tij, i Tejlartësuar qoftë. Pohimi i tyre i rremë përmendet në Kur'an:

“Hebrenjtë thonë: “Dora e Allahut është e shtrënguar.” Iu lidhshin duart atyre dhe qofshin të mallkuar për atë që thonë! Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura. Ai dhuron dhe jep si të dojë. Ajo që të është shpallur ty (Muhamed) nga Zoti yt, me siguri që shumicës prej tyre do t'ua shtojë mosbindjen dhe mohimin. Ne kemi futur ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje deri në Ditën e Kiametit. Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, Allahu e shuan atë. Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë, por Allahu nuk i do ngatërrestarët..”

(el-Ma'ideh: 64)

Koprracia nuk është tipar i panjohur. Ajo mund të gjendet në çdo kohë dhe shoqëri. Mirëpo, dorështrëgimi i çifutëve është diçka tjetër, për dy arsye të rëndësishme: 1. Kjo sjellje buron nga fryma e tyre e brendshme, për shkak

44 Rashed el-Barāwi, *el-Kassas el-Kur'ān*, p. 36.

të tamahut të tyre; 2. Koprracia e shoqërive të tjera mund të gjendet si tipar në individë, kurse dorështrëngimi është tipar etik kolektiv, që mund të gjendet tek çifutët në tërësi si shoqëri. Mbizotërimi i dorështrëngimit tek çifutët është çështje e mirënjohur dhe ky tipar është parulla e tyre ideale e famshme.⁴⁵

Figura dinamike e Kur'anit në ndodhinë e Jusufit⁴⁶ a.s. me gruan e el-Azizit ka treguar shumë aspekte të deprecitimit. Nëpërmjet kësaj historie skandali i bashkëshortes doli sheshit në sytë e të shoqit. Ajo e ndoqi Jusufin a.s., ia shqeu këmishën, pa të shoqin dhe veprimi sikur po ankohej që Jusufi të dënohej: *Cili është dënimi për atë që synoi të ligën ndaj gruas tënde?* Në këtë pikë delikate, ajo nuk e la të shoqin të vendoste. Përkundrazi, ajo mori iniciativën për ta shpallur verdiktin kundër Jusufit a.s. "...përveçse që ai të futet në burg ose të lëndohet tmerrësisht", për ta motivuar dhe nxitur të shoqin. Më vonë, pafajësia e Jusufit a.s. u bë e qartë. Megjithatë, cilat ishin shkaqet e futjes së tij në burg? Ato mund të përmbledhën si më poshtë:

1- Për t'i njoftuar njerëzit se ai ishte fajtor dhe se gruaja e Azizit ishte e pafajshme, duke e treguar atë si keqdashës ndaj saj.

2- Pas futjes së tij në burg, për një periudhë të shkurtër ose të gjatë, ata do ta mbyllnin çështjen, dhe në fund pafajësia e gruas së Azizit do të bëhej e qartë.

3- Burgosja e Jusufit a.s. kondierohet njëfarë dënimi për refuzimin e tij për ofertën e saj (për imoralitet).⁴⁷

Të gjitha këto arsye mund të konsiderohen si manifestime të diktaturës shoqërore dhe politike të kohës kundër besimtarëve, e cila mund të përsëritet kurdo dhe kudo, në sisteme absolutiste dhe autokrate.

Një tjetër mësim që mund të nxirret nga ndodhia e Jusufit a.s. është se matura konsiderohet cilësi e lartë morale, ndërsa ekstremizmi konsiderohet privim dhe burim i të gjitha problemeve.

45 Hafni, p. 260.

46 Shih Sure Jusuf, vargjet: 22-28; Abd el-Hamid el-Suhajbāni, f. 225; Omar Ba Hadhek; *el-Dilalah el-I'jazijah fi Kissati Jusuf*, ff. 23-28; Ibn Tejmijeh, *Makārimu el-Akhlak*, ff. 148-153

47 el-Barawi, ff. 102-104.

Veprimet dhe dashuria e gruas së Azizit ishin plot ekstremizëm të pacipë, i cili e çoi atë të dashurohej me Jusufin a.s., kur ai ishte shërbëtor në pallatin e saj.

Një tjetër mësim që nxirret është se duhet të jemi shumë të kujdesshëm nga ekstremizmi në respekt dhe dashuri. Duhet të jemi të vetëdijshëm për rangjet, arsyet dhe tipet e kësaj dashurie dhe këtij respekti. Po kështu, nuk duhet t'i kalojmë kufijtë e duhur në raportet shoqërore me gratë, të mos anojmë nga bisedat e tyre të ëmbla dhe të lëmuara dhe fjalët e tyre të buta, sepse fitneja e tyre është e madhe, pa harruar se ndëshkimi i Zotit është më i madh, ndaj kujdes prej tyre.⁴⁸

Në ngjarjen e Karunit me popullin e tij, figura dinamike e përdorur e konfirmon se tmerri, gëlltitja nga toka, që ai mori, ishte rezultat i pasurisë së tij të skajshme. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t’i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten.”

(el-Kasas: 81)

Ai u bë vërtet arrogant, vrasës dhe shtypës me pasurinë e tij, dhe i paturp ndaj Zotit. Funksioni shoqëror që mund të nxirret nga ky imazh dinamik është së shumë njerëz përpiqen të pasurohen, pavarësisht nga mjetet dhe mënyra e arritjes së pasurisë. Kjo dukuri shoqërore ka pasojat e saj negative mbi shoqërinë, duke çuar në ndarjen e saj në dy grada shoqërore në thelb: të parët janë ata që kanë monopol ndaj pasurisë dhe janë pakica. Pas tyre është pushteti dhe politika. Klasa e dytë është shumica, dhe këta janë të dobët dhe të shfrytëzuarit.⁴⁹

Dënim që i ra Karunit ishte mësim i qartë për të pasurit dhe të varfrit. Furnizimi ndahet me lejen e Zotit, askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këtë vendim hyjnor dhe askush nuk duhet të synojë atë që ka tjetri. Ja si e sqaron Kur’ani këtë ide:

48 Shih el-Barawi, p. 100; el-Sejid ‘Abd-Rabih, *Buhūth fi Kasas el-Kur’āni*, ff. 191-209; Abu Hafs el-Ansāri, *Zuhr el-Kimam fi Kissati Jusuf alejhi selam*, ff. 193-194; Omar Bahadhek, *el-Ganib al Fanni fi el-Kasas el-Kur’ān*, ff. 113-114.

49 Shih: el-Barawi, p. 129; el-Busti, ff. 148-152.

“Të nesërmen, ata që më parë dëshironin të kishin qenë në vend të tij, thoshin: “Është shumë e qartë se Allahu është Ai që i jep bollëk dhe ia pakëson kujt të dojë prej robërve të Tij. Sikur Allahu të mos kishte mëshirë për ne, me të vërtetë që do të na kishte bërë të na gëlltiste toka. Ububu! Është shumë e qartë se mohuesit nuk kanë shpëtim!””

(el-Kasas: 82)

Një tjetër mësim i rëndësishëm edukativ nga figura dinamike në Kur'an përmban këshillë, udhëzim, dhe thirrje për durim e palëkundshmëri. Nëse besimtari ndesh një sprovë, ai duhet të tregojë durim të madh, kënaqje dhe gatishmëri për ta pranuar atë. Ndryshe nga besimtari i dobët, apo jobesimtari, që nëse diçka e keqe e gjen atë, kthehet në mosbesim pasi ka qenë musliman, dhe me këtë veprim e humbet edhe këtë botë edhe ahiretin, dhe kjo është humbje e qartë. Meditoni për ajetin:

“Disa njerëz të tjerë e adhurojnë Allahun me kusht: Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por, nëse i godet fatkeqësia, ata kthehen në mohim e kështu humbasin këtë botë dhe tjetrën. Pikërisht kjo është humbja e qartë.”

(el-Haxhxh: 11)

Besimtari duhet t'i mbështetet vendimit të Zotit dhe të kënaqet me të. Ai duhet ta kuptojë se të gjitha çështjet janë në duart e Zotit. Nëse i bie një sprovë, kjo vjen prej veprave të tija të këqija, siç thotë Allahu:

*“...Ne asnjëherë nuk u bëmë atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi..” **(en-Nahl: 118)***

Besimtari duhet të mbajë mend se halli dhe sprova janë test nga Krijuesi i tij. Nëse tregon durim dhe palëkundshmëri, do të shpërblehet dhe ndihmohet nga Zoti, duke arritur kënaqësinë e Tij. Le t'i jetë mirënjohës Zotit, atëherë, si në gëzim, ashtu edhe në pikëllim, në kohë të mirë e të këqija.⁵⁰

50 Shih: el-Rāzi, Vvll. 12, ff. 13-14; el-Kurtubi, Vvll. 12, ff. 17-20; Ibn Tejmijeh, ff. 231-239; el-Busti, ff. 157- 165; Ajüb, ff. 484; Ibrahim, ff. 173-179.

Përfundim

Rëndësia e shprehjeve dinamike në kontekstin kur'anor përcakton tiparet e përgjithshme të figurave kur'anore. Pra, shprehja dinamike përfaqëson qendrën rreth të cilës sillen të gjitha elementet e tjera të portretizimit. Veç kësaj, shprehja dinamike në kontekstin kur'anor fokusohet në shumë funksione fetare, edukative, psikologjike, etj, në një mënyrë tëqartë dhe të përpiktë.

Shprehjet dinamike gjenerojnë një lloj ritmi muzikor brenda portretizimit kur'anor përmes aftësisë për të shfrytëzuar potencialet fonetike, gramatike, dhe morfologjike në figuracionin kur'anor. Këto potenciale mund të përfshijnë rritjen e ritmit, sipas natyrës së ngjarjes kur'anore në fjalë, shpalosjen eksplicite të fuqisë dhe surprizës, si dhe për të shpalosur qetësi dhe vazhdimësi në përputhje me objektivat e portretizimit kur'anor.

Shprehjet dinamike kanë fuqinë për t'u zgjeruar mendërisht dhe moralisht, gjë që i bën ato figura të gjallërishtme për lexuesin. Lexuesi mund të përfshihet në këto ngjarje dhe efektet e tyre. Ai mund të marrë pjesë në ndërveprim me shpejtësinë e ngjarjes, realizimin e qëllimit të saj, pritjen e rezultateve të saj dhe bashkëveprimin me ngjyrat e saj. Lexuesi mund të kërkojë burime duke rithurur figurën dinamike të ngjarjes dhe fuqinë e ndikimit të saj mbi marrësin. Kështu, ajetet arrijnë shumë synime.

Paimitueshmëria kur'anore shfaqet qartazi në figurat dinamike të rrëfimit kur'anor. Elokuenca kur'anore merr pjesë në personalizimin e personazheve të ngjarjes dhe ndodhive vijuese, duke zgjedhur kohën dhe vendin e saj. Roli i lëvizjes theksohet nga vizatimi i tipareve të personazhit dhe objektivat e saj, si dhe nga ndihma për zbulimin e mësimëve të përgjithshme që duhen nxjerrë. Veç kësaj, kjo shpie nga skajet e figurës artistike të ngjarjes deri tek kulmi, duke krijuar atmosferë tek marrësi. Kjo e bën atë një pjesëmarrës aktiv në ngjarje, duke u përpjekur për t'i gjetur përgjigje të pranueshme pyetjeve. Ndodhitë e Jusufit me gruan e Azizit dhe të Nuhut me të birin gjatë përmbytjes janë shembuj të mirë. Figura dinamike

luan rol madhor në shembujt kur'anorë. Ajo thekson çështje të caktuara fetare dhe shoqërore sikurse hutimi i hipokritëve dhe konfuzioni i tyre, pozita e atij që merr kamatë, kopracia ose shpërdorimi.

Figura dinamike është e dukshme edhe tek fragmentet mbi Ditën e Gjykimit, ku thekson tmerrin e skenës, çregullinë e ngjarjeve, dhe habinë e njerëzve atë ditë. Kjo arrin synimin në zemrat e besimtarëve si dhe ato të jobesimtarëve. Për besimtarët, kjo është mësim, paralajmërim, mëtim, meditim, dhe përgatitje për vdekjen dhe ringjalljen.

E kundërta dinamike lua rol domethënës në figuracionin kur'anor. Kjo është e dukshme në shumë skena dhe ngjarje. Kundërvënia e figurave materialisht dhe moralisht i qartëson kuptimet dhe mësimet nxirren lehtë. Pikat e forta dhe të dobëta në dy figurat bëhen gjithashtu të qarta. Përcaktimi i pikave të kundërta në figurat dinamike ndihmon në afrimin e qëllimeve siurse adhuruesi asket nga njëra anë dhe adhuruesi i pasinqertë nga tjetra.

Lëvizja e trupit njerëzor ka rol tejet domethënës për konfirmimin e kuptimeve mendore të figurave dinamike kur'anore. Kjo jepet me anë të pendesës, trishtimit, përplasjes së duarve, kafshimit të duarve, sarkazmës së jobesimtarëve, dhe lëvizjeve të tyre të çuditshme sikurse ulja e kokës, mbulimi i krenave me rroba, dhe përkulja e qafave.

Ajetet e figurave dinamike kanë edhe ndikimin e tyre pozitiv psikologjik mbi marrësit (dëgjuesit/lexuesit). Kjo arrihet duke theksuar epërsitë fetare, psikologjike, edukative, informative, artistike dhe shkencore. Funksioni fetar thekson udhëzime të caktuara të lidhura me domosdoshmërinë e bindjes ndaj Zotit, mosndjekjes së dëshirave, përqaftimit të fesë së drejtë, theksimit të shehadetit në publik ose fshehtas, besimit në kadanë dhe kaderin Hyjnor, ndjekjes së urtisë së Tij në shpërndarjen e furnizimit, zbulimit të raportit mes adhuruesit të devotshëm dhe Zotit, përkujtimit të vështirësive që e presin nëse shpërfill skëterrën dhe vuajtjen, përgatitjes për të vdekur më vepra të mira, dhe paraqitjes së rasteve të pendesës dhe keqardhjes që i godet disa adhurues Ditën e Gjykimit.

Funksioni psikologjik i figurës dinamike ka të bëjë me agjtitimin e shpirtin njerëzor. Kjo është e dukshme në figurën e adhuruesve kur thonë la ilahe ilallah, dhe kur tregojnë falje, kënaqje dhe përkujtim të vazhdueshëm të Zotit. Ata i druhen mëkateve dhe ankthit. Kjo figurë përfshin përshkrimin e mëkatarëve në Ditën e Gjykimit. Figura dinamike e vdekjes shpalos shumë domethënie psikologjike përfshirë frikën prej saj, pritjen e saj, dhe përgatitjen për të. Muslimani nuk i frikohet vdekjes dhe duhet të jetë i

gatshëm për të në çdo çast. Kjo arrihet me tekva, punë të mira, pendesë dhe keqardhje. Disa ajete shpalosin se si figurat dinamike pasqyrojnë sjellje të caktuara të papëlqyeshme si psh krekosja e arrogantit me pasurinë dhe fëmijët, e hipokritit me veprat dhe adhurimin e Allahut prej tij, jobesimtarët dhe mëkatarët me keqardhjen e tyre, dhe jobesimtarët me Ditën e Gjykimit.

Funksioni edukativ shpalos shumë praktika serioze shoqërore që duhen evituar. Kamata përbën sëmundjen më të rrezikshme socio-ekonomike dhe Kur'ani paralajmëron për disavantazhet e saj. Vrasja është një krim që ndalhet rreptësisht nga Zoti. Ecja e kapardisur duhet braktisur, duke u zëvendësuar me përulësinë dhe maturinë. Disa praktika paraislame dënohen dhe ndalohen nga Islami, sikurse varrosja e vajzave të sapolindura. Kur'ani bën thirrje për kujdesje dhe respekt ndaj grave. Shumë aspekte negative të sjelljes njerëzore portretizohen në Kur'an, sikurse kopracia, urrejtja dhe zilia. Në këtë drejtim, ajetet kur'anore bëjnë thirrje për kënaqje më varfëri ose pasuri dhe pranim të kaderit të Zotit në të gjitha rastet.

Referenca

- **Al Fakhr Al Razi," Fakhr Al Din Bin Diya Al Din Bin Omar 604 H" *Al Tafsir Al Kabir wa Mafatihul Ghayb*, Dar al fikr, Beirut, 1981**
- **Al Qurtubi," Muhamed bin Abu Bakr Al Ansari 671 H" *Al Jami Li Ahkam Al Qur'an*, Dar Al Hadith, Cairo, 1997**
- **Al Naysaburi," Nidham Al Din Al Hasan Bin Muhamed Al Kumi 728 H" *Gharaib Al Qur'an wa Raghaib Al Furqan*, Tahkek Ibrahim Atwa, Mustafa Al babi Al halabi, Egypt, 1962**
- **Al Shawkani," Muhamed Bin Ali Bin Muhamed 1250 H" *Fath Al Kadir*, Dar Al Fikr Al Arabi, Beirut, 2000**
- **Al Tabari," Abu Jafer Muhamed Bin Jarir 310 H" *Jami Al Bayan An Ta'wil Ayi Al Qur'an*, Tahkek Abdullah Al Turki, Center of Al Buhuth wa Al Dirasat Al Arabiyah wa Al Islamiyah, Dar Hijr, Cairo, 2001**
- **Al Busti," Abu Hatim Muhamed Abdullah Bin Hiban 354 H" *Raudat Al Uqala wa Nuzhat Al Fudala*, Tahkek Muhamed Muhye Al Din Abdul Hameed, Dar Al Kutub Al Ilmiyah, Beirut**
- **Ibn Taymiya," Shaykh Al Islam Taqiyu Din 728 H" *Makarim Al Akhlaq*, Tahkek Abdullah Badran wa Omar Al Haji, Dar Al Khayr, Beirut, 1998**
- **Hasan Ayub, *Al Suluk Al Ijtimaie Fi Al Islam*, Dar Al Buhuth Al Ilmiyah, Cairo, 1979**
- **Ahmad Ibrahim, *Al Fada'il Al Khuluqiyah Fi Al Islam*, Dar Al Olum li-Al tiba'h, Al Riyadh, 1982**
- **Abdul Majeed Al Bayanuni, *Darb Al Amthal Fi Al Qur'an*, Dar Al Kalam, Damascus, 1991**
- **Al Alusi," Abu Al Fadl Shihabu Din Al Sayed Mahmud 1270 H" *Ruh Al Ma'ani Fi TafShihr Al Qur'an Al Kareem Al Adheem wa Al Sabu Al Mathani*, Dar Al Kutub Al Ilmiyah, Beirut, 1994**

- Hasan Ba Jawdah, *Ta'mulat Fi Surat Al Imran*, Al Nadi Al Adabi Al Thaqafi, Jeddah, 1992
- Hasan Ba Jawdah, *Ta'mulat Fi Surat Al Isra*, Dar Al I'tisam, Cairo, 1978
- Ali Al Bajawi wa A'kharuon, *Qasas Al Qur'an*, Al Maktabah Al Tijariyah Al Kubra, Cairo, 1969
- Al Zamakhshari, "Abul Qasim Jarullah Mahmud Bin Omar 538 H" *Al Kashaf*, Tahkek Adil Abdul Mawjood wa Ali Mua'wad, Maktabat Al Obeykan, Saudi Arabia, 1998
- Al Tahir Bin Ashur; *TafShihr Al Tahrir wa Al Tanwir*, Dar Al Tunisiyah Li-Al Nashr, 1984
- Sayed Qutb, *Fi Zilal Al Qur'an*, Dar Al Shuruq, Egypt, 1982
- Abdul Hameed Al Suhaybani, *Al Fitna wa Mawqif Al Muslim Minha Fi Daw'i Al Qur'an*, Dar Al Qasim Li-Al Nashr, Al Riyadh, 1996
- Ibn Hajar Al Askalani, *Fath Al Bari fi Sharh Sahih Al Bukhāri*, Tahkik Abdul Aziz Bin Baz wa Abdurrahman Al Bar-rak, Dar Taibah, Al Riyadh, 2005
- Abdul Karim Al Khatib; *Qis'satā Adem WA Yusuf "Alayhima Al Salam"*, Daru Al Fikr 'Arabi, Egypt, 1974
- Al Ansāri Abu Hafiz; *Zuhru Al Kimām fi Qis'sati Yusuf Alayhi Al Salaam*, Darul Al Kutub Al 'Ilmiyah, Beirūt, 2003
- Omar Ba Hadhek; *Al Dilalatu Al I'gazyah fi Rehab Sureti Yusuf*, Daru Al M'mūn li Al Turāth, Damascus, 1997
- Abd Al Halem Hafni, *Uslūb Al Sukhriyati fi Al Qur'ān Al Karim*, Al Hay'ah Al Masriyah Al Alamiyah Li Al kitab 1992.
- Abd Al aziz abdallah Al Humaydi: *Al Munāfiqūn fi Al Qur'ān*, Daru Al Mujtama Li Al Nashr, Al Riyadh 1996,
- Al Husayn Garnu; *Asalibu Al Tashwiq wa al Ta'ziz fi Al Qur'ān Al Karim*, Muas'assat Al Risalah, Beirut, 1994
- Abdur rahman Al Jarbū'; *Al Amthāl Al Qur'āniyah Al Qiyasiyah Al Madrubati lil Iymān*, Islamic University, Al Madinah Al Munawarah, 2003

- **Abd Al Fattah Lasheen; *Al Bayān fi Dow'i Asālib Al Qur'an*, Dar Al Fikr Al Arabi, Egypt, 2004**
- **Saad Yunus; *Al Tasweer Al Gamāli fi Al Qur'an Al Karim*, Alem Al kutub .Egypt, 2006**
- **Muhammad Said Ramadan Al Bouti; *Manhagun Tarbawiyun Farid*, Darul Hikmah, Beirut, 2003**
- **Abed Al Mageed Al Bayānūni; *Darbu AL Amthali fi Al Qur'an*, Daru Al Qalam, Damascus, 1991**
- **Abu Hay-yan Al Tawhidi (Al Andalusi, Atheer Al Deen Muhamed bin Yusuf bin Ali 745; *Al Bahru Al Muhit*, Dar Ihyaa Aturath Al Arabi, Beirut, 2002**
- **Zakariya Bashir Imām; *Usūl Al Fikr Al Igtima'I fi Al Qur'an Al Karim*, Maktabatu Rawai'u Magdalawi, Jordan, 2000**
- **Ghaythā' Muhammad; *Dirasāt Tarbawiyah fi Wahati Al Zilāl*, 1998 (Library of the Prophet's Mosque in Madina. No publishing house is mentioned)**
- **Muhammad Al Gamāl; *Al Akhlaq wa Al Mu'amalāt fi Al Islām*, Idarat Al Buhuth wa Al Nasher Bil Az'har Al Sharef, Egypt.1975**
- **Rashed Al Barawi; *Al Qasas Al Qur'āni Tafsirun Igtima'i*, Daru Al Nahdati Al 'Arabiyah, Egypt, 1978**
- **Saikolojiyat Al Fukaha wa Al D'hahik, Dar Egypt Li Al Tibaah. Cairo. 1958**
- **Al Suyūti (Jalal Al Din, 911, *Al Dur Al Manthūr Fil Al Tafsir bil Ma'thur*, Markaz Hijr lil Al dirasat Al Islamiyah, Egypt.2003**
- **Al Shawkāni (Muhamed bin Ali bin Muhamed 1250; *Fat'hul Kadir*, Dar Al fikr Al Arab,i Beirut, 2000**
- **Zakariyā Basher Imam; *Usul Al Fikr Al Igtima'i Fe Al Qur'an Al Kareem*, Maktabat Rawa'i Majd Lawei, Jordan.2000**
- **Abdur Rahmān Al Nahlawi; *Usūl Al Tarbiyati Al Islamiya*, Darul Fikr, Damascus, 1983**
- **Al Baydawi (Nasir Adeen Abdullah bin Omar 691: *An war Al Tanzil Wa Asrār Al Ta'wil*, Al Matba'ah Al Uthmaniyah Istanbul 1305**

- **Al Sayed Abed Al hafith; *Buhūth fi Qasas Al Qur'āniy*, Dar Alkitab Allubnanei. Beirut. 1972**